



REVISTË SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" PRISHTINË



Nr. 47 / Qershor 2022

DRITA e نور القرآن KUR'ANIT

www.medreseja.com



për fe e atdhe



70-vjet rrugëtim



Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës



SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË



"Thuaj:
Namazi im, kurbanim (sakrificë ime),
jeta ime dhe vdekja ime janë
për Allahun, Zotin e botëve!"
(El En'am, 162)



Takimi i gjeneratës
2032



PËRMBAJTJA:

- 3 FJALA E REDAKTORIT
- 4 NDJENJË E PA PËRSHKRUESHME
- 5 PAK NGROHTËSI
- 6 E DASHURA MEDRESE
- 6 MEDRESEJA IME
- 7 KOHË E PAPËRSHTATSHME
- 8 PSE E ZGJODHA MEDRESENË?
- 9 VENDI IM
- 9 FRIKA NGA DËSHTIMI
- 9 JETA
- 10 HËNA
- 10 VDEKJA
- 11 SOT
- 11 DUA TË ARRIJ ATJE
- 12 MOS NDALO!
- 12 PËLHURË E FTOHTË
- 12 MBULOI TOKËN
- 12 DURO
- 13 FEMRA
- 14 JAM PENDUAR
- 14 SHQIPNIA
- 15 VETVETJA
- 16 AMBICIA E BESIMTARIT
- 17 RUAJE PAQEN NË SHPIRTIN TËND
EDHE KUR BOTA E PRISH ATË!
- 18 FOTOALBUM
- 24 MANIFESTIMI I DITËLINDJES SË
MUHAMED MUSTAFASË NË
MEDRESENË ALAUDDIN
- 24 AKTIVITETE
- 25 SHËNOHET 70 VJETORI I
"MEDRESESE ALAUDDIN"
- 28 THËNIET E MATURANTËVE
- 31 WE DON'T BLAME THE RAIN
- 31 SONLAR VE YENI BAŞLANGIÇLAR
- 32 ESE ARABISHT
- 34 POEZI
- 42 SPORT
- 45 AKTIVITETE DHE SUKSESE

FJALA E REDAKTORIT

*F*alënderimet tona më të singerta i takojnë Allahut të madhëruar për të gjitha të mirat, e në veçanti që na bëri ta kalojmë një pjesë të jetës tonë duke qenë medresist. Përhëndetjet më të përzemërta qofshin për vullën e pejgamberëve, Mësuesit suprem të njerëzimit, për familjen e tij të ndershme, shokët e tij besnik dhe të gjithë ata që kontribuan në përcjelljen e kësaj feje deri te ne!

Sikurse vitet paraprake, me ndihmën e Allahut arritëm që ta përgatisim edhe këtë numër të revistës sonë. Këtë vit e bëjnë të veçantë sepse i japim fund dy gjërave: përfundimi i një faze të rëndësishme të jetës për ne maturantët dhe përmbyllja e vitit me këtë numër të revistës.

Revista jonë kërkon përkushtim dhe bashkpunim të ndërsjellë. Për këtë arsye i falënderojmë të gjithë nxënësit drejtorinë dhe profesorët për mirëkuptimin dhe përkrahjen e tyre të vazhdueshme.

Gjithashtu, shpresoj që kjo revistë krahas mësimeve dhe krijimtarisë letrare, të reflektojë dritën e kësaj shkolle tek ata njerëz, të cilën nuk janë afër nesh dhe t'i bëj që të kuptojnë për punën dhe angazhimin tonë në këtë shkollë.

Lusim Zotin që ta shtojë zellin, ambiciet dhe punën e pandalshme të medresistëve dhe profesorëve tanë. Qofshin bankat e kësaj shkolle të bekuar burim krenarie për çdo pjestarë të saj!

Hadis Gashi 12/1

Kryeredaktor: **Hadis Gashi 12/1**

Redaktor: **Esma Curri 12/4**

Anëtarë të redaksisë:

**Arian loku 12/1, Amir Pajaziti 12/2,
Amra Kelmendi 12/3, Genta Sadiku 12/4, Elvir By-
tyqi 11/1, Shpat Krasniqi 11/2, Sumeja Gashi 11/3,
Albina Bekolli 11/4, Enes Ramadani 10/1,
Redon Jahja 10/2, Ibrahim Mehmeti 10/3,
Elmedina Ibrahimimi 10/4, Lejla Morina 10/5.**

Lektor dhe redaktor letrar: **Besnik Jaha**

Dizajni: **Bashkim Mehani**

E-mail: **redaksia15@hotmail.com**
www.medreseja.com

Ndjenjë e pa përshkrueshme

Kthimi në kujtimet e para që kisha në këtë shkollë të bekuar, më bën të mendoj, se vërtetë gjërat me vlerë shkojnë shpejt. Në mendje kam një seri kujtimesh të pa harrueshme, të cilat janë dhe do të mbesin gjithmonë kujtimet më të mira të gjatë rrugëtimit tim në këtë vatër të dijes.

Tani e shoh vetën se sa ka ndikuar kjo shkollë me kaq vlera të çmuara në jetën time. Këto vite në medrese më bën që ta kuptoj mirë, se kur Allahu dëshiron që një vendi t'i shtoi vlerë, vërtetë aty do të ketë bereqet të pashtjerrshëm.

Tani si Medresist ndihem në piedistalin më të lartë nga nxënës të tjerë të vendit tim, sepse unë këtu nuk mora vetëm dijen, por çdo gjë elementare e të nevojshme për të ardhmen time. Ky është vendi ku mësohet fjala e Allahut, vendi ku mësohet më e rëndësishmja busollë për njeriun, pra feja, e cila do t'na përcjell deri në momentet e fundit të jetës, e ku ka më mirë se kjo?! Ka kaq shumë gjëra të bukura që mund të thuhën për këtë vend të bekuar, pothuajse të panumërta, por mungesa e të shprehurit sikur me vie nga përzierja e ndjenjave dhe emocioneve që kam për këtë vend. Para se të bëhesha maturant, nuk e besoja që fundi do të vinte kaq shpejtë, por ngadalë e vëreja ndryshimin dhe lëvizjen e kohës. Ah sikur t'i ktheja të gjitha kujtimet dhe t'i shijoja momentet më të lumtura në këtë vend kaq me vlerë! Ah, tani po e vërej se çfarë janë lotët për një vend me rëndësi si ky! Jastëku i shtratit tim në konvikt nuk ka ndjerë kurrë më shumë lot se në këtë natë. Fjalët për këtë shkollë nuk mbarohen kurrë, por këtu i erdhi fundi fjalës sime, ashtu siç erdhi fundi i këtij viti të artë shkollor. Faleminderit o tempull i dijes, faleminderit Medreseja jonë e dashur!

Enes Pajaziti 12/2

Pak ngrohtësi

Ishte mëngjes i freskët shtatori, u zgjova më herët se zakonisht. E dija që do të ishte një ditë e gjatë dhe shumë e rëndësishme për mua dhe se do të filloj një kapitull të ri në jetën time, një rrugëtim i gjatë dhe shumë të bukur. Ndalem dhe mendoj, më duket sikur të ketë ndodhur dje. Ishte dita kur do të merrja titullin medresist.

U nisa për në shkollë me emocione te pa për shkrueshme dhe lash ngrohtësinë e shtëpisë, por në medrese gjeta mikpritjen dhe po atë ngrohtësi që e kisha disa minuta më parë. Disa thoshin

se nuk ishte hera e parë në atë vend, dhe me pyesnin: pse kisha kaq shumë emocione. Ishte e vërtetë se nuk isha për të parën herë në atë ambient, por atë ngrohtësi nuk e kisha ndierë kurrë më parë. Shihja fytyra të reja dhe thosha me vete: këto fytyra do të më shoqërojnë në këtë udhëtim tre vjeçar, me kujtime të shumta?! E dija që nuk do të ishte një rrugëtim i lehtë duke marrë parasysh faktin se, shumica prej nesh nuk njiheshim, vinim nga vende të ndryshme, një ndjenjë e panjohur për të gjithë të qëndronim larg familjeve për një periudhë të gjatë.

Nuk shkoi shumë kohë kur u obliguam të ndërprejmë procesin e rregullt mësimor për shkak të një sëmundje ngjithëse -(Covid-19).

Mësimi në distancë ishte i vështirë, po aq sa edhe përballja me atë sëmundje që veçse ishte shtrirë në tërë botën. Gjithashtu ishte shkëputur një hallkë e fortë për ne si medresist, e ajo ishte miqësia e konviktit dhe diskutimet në bankat e ngrohta e me plot entuziazëm në ato debate që për ne si klasë “e zhurmshme” nuk kishin fund. As ne nuk e kuptuam se si kaloi ajo periudhë me shumë ndikim të pashpjegueshëm në personalitetin tim?!

Ja ku jemi sot, pothuajse në përfundim të këtij rrugëtimi, por çdoherë me kënaqësinë dhe vullnetin e ditës së parë që na përcolli gjatë gjithë kësaj kohe. Vetëm se, sot sa herë marr rrugën për në Medrese, kam po atë ndjenjë që po shkoj në shtëpi dhe po takoj atë familje të zgjedhur. Të zgjedhur për mua, por jo nga unë, dhe sikur të ishte në dorën time, më mirë nuk do të kisha mundur t’i selektoja secilin nga miqtë, që për mendimin tim, secili e plotësojmë njëri-tjetrin, në një mënyrë ose tjetrën. Shkëputja nga kjo familje e madhe do të jetë e vështirë e sidomos nga kjo shoqëri e pa harruar pas një rrugëtimi me shumë kënaqësi e pak mërzë. Por, nga unë do të ketë vetëm dashuri të cilën nuk mund ta përshkruaj dhe respekt të pa fund.

Amir Pajaziti 12/2



Medreseja ime

Edhe po ika, ti mos më harro se në fund të fundit të deshta më shumë se gjithçka! Medreseja ime, edhe po ika ti mos më harro, as zërin tim e as hapat e mi! Karrigen time mos ta ngrohë ndokush tjetër, se mbase kthehem, ndoshta, jo që të qëndroj, por që t'vij e të ngroh shpirtin sa herë të jem e thyer, për këtë jam e sigurt! Karrigen time lëre të zbrazët se mbase kthehem, ndoshta si në vendin e kujtimeve më të bukura dhe në vendin ku gjeta një familje!

Pastaj na falë, na falë që nuk të lëmë të qetë qoftë edhe për një moment të vetëm! Na fal që nuk të lëmë të qetë teksa të tregonim dertet dhe gëzimet tona! Na falë që duke dashur t'përqa-fonim aq shumë, ndoshta edhe të lënduam. Na falë që në fillimet tona të urrenim se nuk të njih-nim, e pas fjalës më fal, kam shumë falënderime për ty. Faleminderit... faleminderit që na rrite për tre vite radhazi! Faleminderit për rrugën që kishim marrë, ishe mbështetja më e madhe, faleminderit që na mbajte këtu e na mundësove të fitojmë edhe kënaqësinë e Allahut ndër të tjera! Sikur ta dinin të gjithë lumturinë brenda këtyre mureve, sikur ta dinin se këtu s'ka të bëj me fjalën miqësi e as shkollë, sikur ta dinin se zëvendësim i këtyre dy fjalëve është familja e shtëpia.

E djeshmja na e solli fillimin, e nesërmja po na e sjell fundin, e diku në mes të dyjave Allahu na e dhuroi kohën që të donim njëra-tjetrën për hir të Tij. Çdo herë kam fol e shkruar për shoqëri, e asnjë fjalë të atyre shkronjave, asnjëherë nuk e kam ndje, e sot këtu falë jush aq shumë shoqërinë e ndjejë, mbase as me përshkrua me fjalë nuk di.

Ah sikur ta dinim e të mos dashuroheshim në këto banka, se ilaç për këtë gjë nuk paska! Sikur t'mos i mësonim veshët me këta zëra, e sytë mos t'i mësonim me pamjen tënde, ti më e dashura e zemrës, ndoshta më pak e dhimbshme do të ishte

Falënderimi shkon për ty që u bërë për ne si drita në fund të tunelit, do të ruhesh gjithmonë thellë në oqeanet e ndjenjave, në zemrat tona, do të mbetesh gjithmonë kujtimi më i bukur!

Vlerona Blenishti 12/3

E DASHURA MEDRESE

Më doli gjumi, e nga sytë më rrodhën ca lot duke menduar për ty medrese. Sa e sa të mira m'i ofrove, e mendoj se si mund t'i kthej?! Nuk e di se si... më ruajte nga e keqja në këto kohë kur shumë bashkëkohanikë të mi kanë nevojë për mësim të tilla. Sa lëndë të begatëta gjejmë tek ti medrese!

Tani po filloj të shoh se sa përfitova. Sa të begatë qenkan këta profesorë, që na shohin si bijtë e tyre! Ata çdo herë mundohen ta bëjnë më të mirën për neve, e ta mënjanojnë të keqen. Sa i begatë qenka ky konvikt, edhe pse larg familjeve tona, aty gjetëm ngrohtësinë familjare! Sa e begatë kjo shoqëri, ku secili tjetrit iu bë si vëlla, ku gjetëm prehje për brengat tona, ku luajtëm bashkë, hëngrëm bashkë, pimë bashkë, flemë bashkë, morëm abdes bashkë, u falëm bashkë, qeshëm bashkë e do të qajmë bashkë!

Florian Miftari 12/1

KOHË e papërshtatshme

Nuk e kam zanafillë të shkruaj, por mallëngjimi dhe ndjenjat për gjëra të rëndësishme, e në këtë rast për Medresenë, merr hovin e vet dhe fjalët shpërthejnë nga brenda.

Kur erdha në këtë vend ishte plotësisht i pa njohur për mua, nuk dija se çfarë do të bëhej, isha plotësisht i pa përgatitur, fytyra krejtësisht të pa njohura, e që më vonë do t'i quaja familje. Emocione të flakta në çdo moment, a thua se kush do të jenë ata që do të na shkrijnë dijen e tyre tek ne?! Kush do të jenë ata udhërrëfyes të dijes sonë për tre vite? Ata ishin dhe janë profesorët po të kësaj vatre të dijes.

Tri vite kaluan shpejt, virusi "Covid-19" e bëri të veten, dhe me gjithë pasojat që solli, mori dhe la shumë kujtime nga këto banka shkollore edhe për ne konviktorët. Ne sapo kishim filluar hapat e parë drejt njohjes së një jete ndryshe e jashtë familjes, me shokët e klasës, por që na u dasht që t'i ndërprejmë lidhjet e brishta të krijuara me këtë vend. Edhe viti i dytë filloi me gëzimin e kthimit përsëri në bankat shkollore. Bisedat tona shpesh na kthenin te periudha dhe ngjarjet e kaluar gjatë periudhës së mësimin 'online', por përsëri kishte një zbrazëti në klasë, pasi që gjysma tjetër e klasës vazhdonin mësimin 'online'.

Të heshtur si gjithmonë, sigurisht edhe të përgjumur, se nuk bëhej ndryshe, sapo profesorët merrnin numrin e mungesave, ndalnim kamerat dhe shijonim pjesën tjetër të mësimin të përzier me ëndrrat dyzetminutëshe, që duhet t'i prishnim raste-raste nëse përmendej emri ynë. Ishin momente shumë të veçanta për secilin prej nesh, e që tani duket sikur një ëndërr gjysmë e mjegullt. Me kohë, kishim filluar ta njihnim njeri-tjetrin më tepër, por përsëri, me ndarjen e klasës në grupe, ishte krijuar vakum shqetësues.

Koha kalonte shpejt, sa hap e mbyll sytë. Ja, dolëm në vitin e tretë! Tani ndoshta dukemi më të pjekur, por faktikisht kemi ende nevojë për kujdesin e këshillat që çdo herë i merrnim nga kujdestarët dhe profesorët tanë, e tani ato do të na mungojnë.

Pas gjithë kësaj, lexues dhe medresist i dashur, ti që ende je në ato ambiente, dua të të këshilloj: shijo momentet me shokët e shkollës, me profesorët dhe stafin që kujdeset për ty, shijo momentet e të qëndruarit në konvikt, kalo mirë me shokët, sepse krejt në fund do t'ua kërkosh hallallin!

Emir Mehani 12/2

PSE E ZGJODHA MEDRESENË?

Që të shkoja në medrese ka qenë njëra prej ëndrrave të mia. Arsye kryesore ka qenë , sepse edhe prindi im dhe disa familjarë tjerë, kanë mësuar në këtë shkollë. Por, një motivim shtesë për të ardhur në këtë shkollë, ka qenë gjyshi im. Ai më këshilloi të vija këtu dhe se do të krenohej me mua. Më vonë kur mora lajmin se u pranova, të gjithë u gëzuan dhe më uruan,

Para se të filloja shkollimin këtu, gjyshi im ndërroi jetë. E kam ngushëlluar veten duke menduar që ai do të ishte krenar që u pranova këtu.

Sot unë krenohem që jam një nxënës në „Medresenë Alauddin“ në Prishtinë dhe se familja ime më ka përkrahur në këtë zgjedhje timen. Ju them me shume sinqeritet, se ky vit më kaloi shumë shpejt dhe ditët kalonin si orë.

Omer Hasani 10/3

Në një kaos ndjenjash, në një katrahurë mendimesh e opsionesh, në një revoltë njerëzish, e luftë mes mendjes e zemrës, ne e zgjedhëm të duhurën. Si dallgët e ashpra të detit ashtu edhe unë shtrëngova timonin plotë forcë, injorova piratet, e gjallesat përplot m'u bënë flutura dhe zgjodha drejtimin e duhur s'paku kështu

Jetës time mendova dhe vendosa t'ia hedh pak pika lumturie me dijen ndaj Zotit e ca dritë me diturinë mbi shkencën. Kështu, vendosa të vijë në Medrese, ku këto dy dukuri të bëhen një, duke më bërë vajzën ideale që prindërit e mi gjithmonë e kanë ëndërruar. Ta bëj krenar babin tim, që sot më vëzhgon prej lartë e mburret me arritjet e mia.

Faqet e kësaj etape që kam filluar, kanë takuar shkronjat e para. Jam shumë e bindur që do t'i thuri fjalët më të mira, e do t'i stolis vargjet më të bukura në të. Madje kam filluar t'a imagjinoj edhe faqen e fundit, por jo se më ngjall mall e nuk dua të shkoj aq shpejt. Shpresoj të vijë ajo ditë e unë të mos pendohem për diçka që nuk e kam bërë, apo për momentet që i kisha para e nuk i shfrytëzova. Jeta e bukur po më pretë , po vazhdoj faqen tjetër.

Someja Berisha 10/4

Vendi im

Ndjej mall... nuk e kisha besuar kurrë, por me të vërtetë po ndjej mall. Më kaplon kjo ndjenjë sa herë dua të shoh diçka jashtë dritares. Pamja më vret sytë, shpirti nuk ndihet mirë. Pastaj mbylli sytë dhe filloi t'ua imagjinoj pamjen që do të doja ta shihja natyrën e cila do të më bënte të ndihem mire. Shoh rrugën e gjerë e cila rrethon fshatin e stolisur me fusha, kodra, male, gëzim e hare. Ato fusha që kur këmba më shkel, zemra ndihet aq e sigurt. Aty ku ndihem vetvetja.

Vendi im ku do të qëndroja ndoshta edhe me shekuj, dhe nuk do të largohesha për asnjë arsye. Se ky vend ishte shpëtim për të parët e gjakut tim. U bë vend strehim e fole në kohën më të vështirë të tyre. Atë ndjesi më jep edhe mua sot. Kur largohem nga ai, ndihem si zogui i trishtuar që lë follenë.

Ndoshta shtegtoj me kilometra, por vendim tim se kam kurrë larg, ngase e kam me vete kudo që të jem. Kudo që të shkoj, mendja ime më ndihmon ta mbarti. Një lutje kam për ty o vend i bekuar, të lutem më prit!

Mos e prano pranverën pa mua, mos gjallëro në mungesën time. Prit, se unë do të vij!

Ajan Kamenica 10/3



Jeta

Jeta është si një kandil që dikur do të shuhet. Pra, ne duhet të jemi vetvetja. Të jemi artist të jetës sonë, mos t'ia lemë brushën askujt tjetër.

Jeta e pyeti vdekjen: pse të gjithë më duan vetëm mua? Vdekja iu përgjigj: jam e vërteta e hidhur, sikurse qiri i cili shkrihet e nuk kthehet më në gjendjen e tij të mëparshme, ashtu edhe jeta shkon e. nuk kthehet më.

Albert Ajnshtajni ka thënë: "mëso nga e djeshmja, jeto të sotmen dhe shpresë për të nesërmen"! E nesërmen kurrë nuk është e garantuar.

Amar Ganiu 10/2



Frika nga dështimi

Dështimi është një realitet që rrallë njerëzit e pranojnë. Njerëzit janë inferiorë, parapëlqejnë të dalin në sytë e të tjerëve më të mirë se sa që janë.

Gjatë jetës hasim plot dështime, por i cilësojmë si më të ulëtat.

Kur të vijnë të këqijat dhe dështimet, duhet vetëm t'ua hapim derën, sepse përnjëherë të vijnë të gjitha, e ndihesh i lodhur, përkundër ditëve, netëve, njerëzve, e shoqërisë. Ndihehesh i lodhur nga njerëzit... , me një fjalë ndihesh i lodhur nga vetvetja.

Fatkeqësisht disa njerëz problemet e tyre ia hedhin tjerëve, epo problemi ndodhet pikërisht në vetvete.

Mposhti dështimet, e triumfo mbi to, sepse fitorja dhe suksesi gjenden pikërisht në vetveten!


Eron Hajdini 10/3



Hëna

Hëna nuk është vetëm një satelit, ajo është destinacioni ku të gjithë të vetmuarit takohen. Është kurimi i plagëve të zemrës. Drita e saj depërton në thellësinë e shpirtave të tyre. Ata flasin me të, i tregojnë për ditën e tyre, për jetën dhe problemet e tyre. Ani pse ajo nuk flet, mjafton prania e saj në mesin e natës. Hëna është lidhja e vetme që ata e mbajnë, sepse ajo ruan sekretet e tyre. Hëna është burim inspirimi prej së cilës rrjedhin me miliona fjalë shpirti. Sa vargje poetike iu dedikuan asaj, sepse vetëm ajo ishte shpëtimi i tyre. Është e domosdoshme për secilin prej nesh që të dalim qoftë edhe vetëm një herë e të shohim mrekullinë e Hënës. Mendoni se Hëna u rrëmben zemrat e njerëzve vetëm se flasin me të?! Jo, është një fshehtësi tjetër këtu. Kjo, Hënë para, shumë shekuj u ça për dashurin ndaj të dashurit të Allahut, andaj forca tërheqëse që na tërheq drejt saj nuk është vetëm se dëgjon mërzitë tona, por bukuria e dashurisë ndaj saj, që sot ne shkrihem për të.

Esma Curri 12/4



Vdekja

Vdekja si fjalë, diçka e frikshme. Shumëkush e quajmë si “fondi i gjithçkaje”, por në fakt është fillimi i jetës së mëtejshme. Disa nuk kanë dijeni se vdekja na shpie para Krijuesit, na tregon rezultatin e veprave që kemi bërë në jetën e përkohshme. Sa e çuditshme! Mendojmë se do të vdesim kur të plakemi, duke mos ditur se vdekjen e kemi më afër se damarin e qafës.

Vdekja i vjen çdokujt, edhe të pasurit edhe të varfëritë, si të ziut ashtu edhe të bardhit, si të moshuarit ashtu edhe të riut. Këtë na e dëshmon një ajet kuranor, ku Allahu xh.sh. në Kur'an na thotë: “Kudo që të gjendeni do t’iu arrijë vdekja, madje qofshi edhe në kështjellat më të forta.” (Surja Nisa: 78). Njerëzit gjithmonë thonë: “shfrytëzoje kohën sepse një jetë ke!”. Po, e vërtetë, një jetë kemi, po sikur ta shfrytëzonim kohën duke u falur, duke adhuruar Allahun, duke dhënë zekat, duke bërë vepra të mira, duke respektuar prindërit, vdekja do të jetë më e ëmël.

Andaj të gjithë duhet ta dimë se vdekja nuk do të thotë përfundim, por vetëm një derë përmes së cilës kalojmë te jeta e vërtetë, e cila zgjatë deri në pafundësi. Jeta që po jetojmë është thjeshtë një test. Allahu na dha të mira të panumërta në këtë botë për të parë se si do të sillemi duke i pasur gjithë këto begati. Pastaj Ai krijoi Xhennetin dhe Xhehenemin, si shpërblim apo ndëshkim për neve. Edhe për këtë kemi argument në Kur'anin famëlartë ku Allahu thotë “Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në ditën e gjykimit) shpërblehet dhjetëfish, e kush vjen me (vepër) të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të. Atyre nuk u bëhet e padrejtë. (Enam:160)”. Pra, o njeri, frikësohu, nga dënimi i varrit, nga ndëshkimi i mëtejshëm, nga zjarri i xhehenemit, e jo nga sprovat kalimtare të kësaj bote të përkohshme!

Sumeja Gashi 11/3



Sot

U zgjova sot edhe pse s' dija a do zgjohesha apo jo, iu luta Zotit për një të nesërme më të mirë, dhe shpresova për një ditë më ndryshe.

Më doli gjumi, prapë thashë mirë mëngjes, prapë e pashë diellin duke lindur.

O e sotme që nesër do të jesh e djeshme, nuk do të mërzitem se çfarë do të ndodh me ty! Do të shpresoj se ti do të bësh më të mirën për mua, por edhe nëse nuk e bën s' do të mërzitem se e djeshmja kalon e ikën dhe as nuk kthehet. E pse të kujtoj kot kur nuk mund të ndryshoj dot?!

Pse të harroj ty o e djeshme, s' do të thotë që s' do të punoj për një të nesërme më të mirë?!

S' ka rëndësi nëse s' i marrë të gjitha, me rëndësi s' do të bëhem pishman pse s' punova. Do të mërzitem ndoshta, por me rëndësi dot mund t' i them vetes : ti punove sot, por nesër do të punosh më shumë dhe do t' a dalësh!

Pse, kush arriti në shkallën e fundit pa prekur të parën?!

Leje të djeshmen se ajo ka kaluar! Shikoje të sotmen, e puno për të nesërmen!

Ndonjëherë kthimi mbrapa është rreziku më i madh, ndonjëherë shikimi para është suksesi më i madh. Prandaj, puno sot, mundesh ta ndryshosh të nesërmen dhe nuk mund të bësh asgjë për të djeshmen, sa do që revoltosh! Andaj puno përkatësisht për secilën ditë, e ajo që kalon ka kaluar!

Mërzitu kur s' punon, por gëzohu kur mundohesh!

Krenare Lipovica 11/3

Dua të arrij atje

A tje...

Atje dua të arrij. Dua t' i arrij majat më të larta të suksesit. Dua ta shoh veten me një këndvështrim tjetër. T' i shoh aftësitë e mia, kapacitetin tim për të arritur diçka.

Qëllimi ynë në këtë jetë, është të vendosim një objektiv, të synojmë diçka për të ardhmen.

Atje, atje pra dua të shkoj. Jam rrugës, po i ngjitem shkallëve dalëngadalë. Oh jo, e shpejtova vrapin shumë, e tash u rrëzoja, madje shumë keq, se edhe u lëndova e shkova shumë poshtë. Atë zbritje te poshtë e vuajta shumë. E mallkova aq shumë sa që i rashë pishman se, pse e mora këtë rrugë kaq të gjatë?! Një zë i brendshëm më thotë se jeta është kështu, përplot batica e zbatice, ngritje dhe ulje.

Atje, atje dua të shkoj, pavarësisht gjithçkaje, unë nuk u dorëzoja, nuk mbeta poshtë. Fillova t' i ngjitem shkallëve përsëri. E ato shkallë, nuk janë lëvizëse, të më qojnë aq shpejt, jo. Por punova aq fort dhe me aq vullnet sa që vazhdova vetëm përpara, e asgjë nuk guxojë të më ndalon-te. Ndikimi i jashtëm është aq i fuqishëm sa që të bën për vehte, të merr, t' i kontrollon ndjenjat, t' i shkatërron edhe ëndrrat. E unë, mbylla sytë e mbylla veshët, e vetëm vazhdova tutje.

Unë kam edhe shumë rrugë për të bërë, një rrugë me plot e përplot sfida, të cilat po më presin. Nuk do të dorëzohem, do të vazhdoj deri sa t' i arrij majat më të larta të suksesit.

Eljesa Maxhuni 10/4

MOS NDALO

Mos harro, se lëkura rrudhet, e flokët zbardhen!

Ditët bëhen vite, por më e rëndësishmja nuk ndryshon kurrë,

Forca jote e bindja jote, nuk njohin moshë,

Pas çdo pikë arritje ka një pikënisje, pas çdo suksesi një zhgënjim,

Përderisa je gjallë, gjallëro!

Mos rri duke parë fotografi të zverdhura nga koha!

Sillu në mënyrë që në vend të mëshirës, të gëzosh respekt!

Kur të rendojnë vitet, e nuk mundesh më të vraposh, ec shpejt!

Kur nuk dot mundesh të ecësh , provo përsëri, e kur as hapin nuk dot mundesh ta bësh, zvarritu! Veç për t'u ndal, kurrë mos ndalo!

Elmedina Ibrahim 10/4

PËLHURË E FTOHTË MBULOI TOKËN

Janar... tani tokën e mbështolli acari, pemët e zhveshura aty pari, shohim fëmijët që skijojnë me prindër. Përtej kodrës plot borë, lë gjurmë këpuca ime, ashtu sikur kujtimet thellë në zemrën time. Në shtëpi zjarri i kuq si gjaku, e motra e vogël thërret: "Nanë jam ngri!" faqe kuqe e lozonjare ia shton hijeshinë shtëpisë. Bora fjolla-fjolla endet tej dritareve e unë kënaqesha me atë bukuri të bardhë.

Prisja me padurim të nisesha, dorëzat që gjyshja m'i kishte qëndisë i ruaja si gjënë më të bukur, i mora i vendosa në duar për me n'di ngrohtësinë, sa mall që pata ...shallin vetes ia vendosa, rrugës për shkollë ia fillova. Zilja e orës u dëgjua, nga nxehtësia xhami u avullua. Ngushëllimi e gëzimi tek bredhat po rrinin... sytë e mi shkëlqenin, gjithçka dukej e bardhë. Pëlhura e ftohtë mbuloi tokën, teksa po e vesh-troja tërë kohën!

Dua Çmega 10/4



DURO!

Duro e lufto shumë pas tyre pavarësisht fjalëve zhgënjyese të njerëzve!

Duro dhe kapu fort pas tyre, që kur njerëzit të shohin, të habiten që je ende në përpjekje për realizimin e tyre!

Kujtoje Nuhun a.s kur thirri në Islam përplot 950 vite pa ndërprerë me mbështetje në Allahun e Lartësuar, si të gjithë të Dërguarit e tjerë për sabrin e tyre!

Duro deri sa të arrish në majat e asaj që ke ëndërruar ditë e natë, deri aty ku njerëzit mundoheshin të ulnin aq poshtë e t'i zbehin ato ëndërra, e pastaj edhe t'i zhdukën, edhe pse i krijove me gjithë shpirt!

Sabër, o njeri e mbështetu fuqishëm në Allahun e Madhërishëm!

Sabër, se çka është caktuar për ty, do të vijë në kohën e duhur!

Sabër, se pas vështirësisë vjen lehtësimi!

Vetëm sabër.

Elma Krasniqi 10/4


FEMRA

Pse? Çfarë? Ku? Si? Je lodhur tashmë apo jo?! Je lodhur duke qenë cak thumbimi, je lodhur duke i dëgjuar britmat e atyre që gjuha vetëm u punon e nuk di të ndalet. Nuk është turp të dëgjosh shpirtin tënd e të thuash : “oh u lodha më!”. Por, dije se turp është të e rëndosh shpirtin e të vazhdosh sikur je mirë, sikur asgjë nuk ka ndodhur. E po të kthesh kokën mbrapa, do të shohësh njolla gjaku që burojnë nga zemra e stërlodhur, e stërmunduar.

A nuk mundem unë?! A nuk di?! A do të dështoj?! Pyetje të shpeshta në kokën tënde, ama jo pa përgjigje. Ti mundesh, ti di dhe ti do t'ia dalësh. Do t'ia arrish, sepse je një qenie e fortë që di t'u bësh ballë sfidave, di të qetësohesh ashtu si fëmijë i vogël e i porsalindur që qetësohet në duart e sigurta të nënës, të një gruaje që shpirti i saj është ashtu si pambuku, duart e saja janë mburoja që nuk thyhen lehtë e mendja e saj është oqean që nuk shteron. A ke dëgjuar fjalë më të ëmbël se fjala Nënë?!

Këtu mbaron fjalia. Nuk ka vazhdim tjetër, sepse ajo vetë është vazhdimësi.

Elmedina Ibrahimimi 10/4



JAM PENDUAR

A thua do të lulëzoj porsi pranvera në mes prillit?! A thua do shndrisë si yjet në kupë të qiellit?! A thua do të më duan, porsi bleta polenin?! Pyes veten, a do ta mbaj rendin? Sikur qiriu po më shuhej, rruga më është errësuar, zëra të ndryshëm e të huaj po m'bertasin si të tmerruar. Po më thonë se s'jam mjaftueshëm për të arritur atë që dua. Mendja më thotë lëri këto llafe, teksa zemra lotët m'i solli n'faqe.

Ndonjëherë them se unë kam faj, se ëndrrat e mia janë më të flakta, si ky zjarri që ngroh shtëpinë në ditë të acarta. Më është bërë mjegull para udhës, s'dalloj qartë t'mirën e nënës, e gjykimet e asnjans. Edhe lulja që e mbaj në dritare, si me u zbehë ajo petale, duke shikua diellin tek perëndon, syri më vajton.

Buzëqeshja më është larguar, fjala gojën e ka harruar ... pse s'e dëgjova shpirtin tim, se jam e mirë në këtë rrugëtim?! Pse bëra me hile n'peshore të jetës duke e rëndua atë të keqen, e tu e largua të mirën?! Jam penduar, për besë po. Se të kisha besim në vete, problemeve i kisha gjet zgjidhje. Jam penduar, pasha kohën, që ditët i shihja tu kalua, e arritje askurrkund. Jam penduar, pasha tokën, se kam shkel dëshirën sikur zallin e shkretinës. Mos u ndruaj e imja shoqe, jepi vetes, mos ndalo për kot, se suksesin e ke për mot, librin e ke shok, mësimdhënësin fqinjë e armik dorëzimin!

Dua Çmega 10/4

SHQIPNIA

Paj, edhe dielli Do t'ketë ni, edhe hana do t'ketë marre vesh, se si vendi jonë, nuk ka! Nuk ka si Shqipnia jonë e bukur!

Me ato male e fusha t'gjëra me lule, nën at qiell përherë t'kulluem.

Mbi ato male e bjeshkë kreshnike, sillen ata djem porsi zana.

Atje janë le Toskë e Gegë, si dy rreze që dalin nga kupa e qiellit.


Ato male të madhnueshme, edhe ato dot kenë pa, se sa armiku në vend t'shqiptarit ka ra.

Dridhet toka e gjëmon deti, e shqiptari sy për sy po këqyr armikun, edhe jetën për këtë vend me dhanë, ka bâ be, ka me luftu dej n'frymë të fundit.

Oj Shqipni moj "zojë e randë", shkund pluhurin njëherë e qoje kryet nalt si mbretëshë, qysh t'ka hije, se me djemtë që ke rritur, e ke ushqye prej gjinit tënd, s'mundesh me u quajt robneshë.

Ditë sotit, burrë shqiptar kushdo i thotë vetit, po djemtë që ti ke rritë, lum ata t' lumtë, që dhanë jetën për atdhe, që derdhën gjak tue luftue. E ata kurrë mos u harrofshin se luftuan deri n'frymën të fundit! Prandaj bëhu krenare për djemtë e tu Shqipni, bëhu krenare!

Eljesa Maxhuni 10/4



Vetvetja

A ke arritur të njohësh vetën tënde?! Apo mos ndoshta je zhytur në mendimet e të tjerëve siç zhytet zhytësi në thellësi të oqeanit, ke humbur dhe nuk di të dalësh?! Apo mos ndoshta frika ka shtrirë rrënjët e saj në gjoksin tënd dhe tani të pengon të marrësh frymë?!

Frenat e jetës duhet t'i mbash ti, as miku e as armiku, sepse shpejtësia e udhëtimit do të jetë e madhe e frenimi i papritur shkaktonte dëm. Sekretin që ti sapo i'a tregove mikut, ia dorëzove frenat e jetës tënde, dhe kur të arrish shpejtësinë më të madhe ai mund të frenoj në çdo qast e ti mund të biesh se nuk ke nga të mbahesh. Sekretin që ti sapo i'a tregove mikut, i'a dhurove minutat e jetës tënde, e ai mund t'i ndal në çastin më të rëndësishëm e ti nuk duron dot dhe ndalesh bashkë me to.

Vetvetja është zgjedhja, është e ardhmja, është e drejta jote, prandaj mos lejo retë e zeza të mbulojnë shpirtin tënd e mos të shohësh diellin i cili ndriçon aq bukur! Mos lejo që sytë e tu të shohin gjembat e trëndafilin, por petalet e tij, aromën e tij e ngjyrën shpresëdhënëse!

Ji vetvetja, kur të janë mbyllur dyert e nuk ke vend për të trokitur, trokit në derën e shpresës dhe të ëndrrës! Ajo derë asnjëherë nuk mund të jetë e kyçur për ty. Krijë urën tënde në mes të tashmes dhe të ardhmes, por mos u ndal në mes, se mund të shembet e të t'i mbytet ëndrrat e tua! Vazhdo duke fluturuar, duke vrapuar, duke ecur zvarrë, por mbi të gjitha, vazhdo, vazhdo me atë forcën që mësove, vazhdo e lënduar, por mos u ndal, kalo pengesat ashtu si vala godet bregun dhe çdo gjë që i del përballë! Lufto, por jo me egoizëm, lufto, por jo me tradhti, por jo me ligësi, lufto me mençurinë tënde, dijen tënde, vullnetin tënd, ëndrrën tënde, e të ardhmen tënde, synimin tënd e mbi të gjitha realizo dhe prapë vazhdo! Po sikur piloti të ndalojë në gjysmë të udhëtimit dhe të fillonte uljen pa parë pistën, përplasja do të ishte e pashmangshme, e sikur të duronte deri në fund, udhëtimi do të realizohej. Jeta nuk përsëritet, ashtu sikurse nuk përsëritet as pika e njëjtë e shiut, e a nuk erdhi koha?! A nuk erdhi koha?! A nuk erdhi koha të jesh vetja jote, qenia jote, të jesh komandanti i egos tënde e jo ushtarë që komandojnë për ty?! Shto veprat e pakëso fjalët, sepse është shiu ai i cili i rrit lulet e jo bubullima! Zgjo-hu, përgatitu dhe nis, e kujtoja gjithmonë vetes se ti mund t'ia dalësh!

Ambicia e besimtarit

Allahu i Lartësuar kur e krijoi njeriun, i dha atij shumë mundësi, e ka dalluar atë nga krijesat tjera, i ka dhënë mendjen me të cilën logjikon, dallon të mirën dhe të keqen, të dobishmen dhe të dëmshmen. E tërë kjo që të përsoset personaliteti i tij dhe të balancohen bazamentet e jetës së tij.

Për të pasur sukses në jetë, qoftë personalisht apo profesionalisht, njeriu ka nevojë t'i sistemojë qëllimet. Në fund të fundit, është e nevojshme që të fitoni rezultate të knaqshme duke ndjekur aspiratat tuaja. Duke pasur parasysh gjeneratat e reja, me ndryshimet dinamike të gjërave, me lehtësime në gjërat elementare, zhduket nevoja e qëllimit të jetës. Me këto fjalë nënkuptohet se kemi njerëz që janë të shkathët në lëmi të ndryshme, e që qëllimi i tyre është i fiksuar, por fatkeqësisht kemi edhe të kundërtën, që nuk e kanë qëllimin as të menduar, e që nuk preferohet të jemi pjesë e grupit të dytë.

Megjithatë ne po fokusohemi aty ku qëllimi i secilit prej nesh duhet të fiksohet, se sa jemi të mirë në raport me ibadetet tona.

Ka disa besimtarë, të cilët mjaftohen me kryerjen e obligimeve esenciale, mjaftohen me shfaqjen e jashtme të përkushtimit fetar, e komplet e anashkalon brendinë. Deri diku mbetet i kënaqur me angazhimet e tij në punë të hajrit, por e vëren dhe e kërkon seriozitetin e iniciativën, në mënyrë që të motivohet më shumë. E nga nuk e dimë ne se këtij personit krejt çka i mungon janë objektivat.

Ambiciet e tilla janë një lloj zgjimi shpirtëror me të cilin shkëlmohet përtacia, zhduken preokupimet, e asgjësohen angazhimet me të cilat defokusojmë dhe harxhojmë kohë. E përveç ngjarjeve na vërteton Allahu xh.sh në Kur'an:

“Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira.” (El-Bekare, 148)

Na pikëllon fakti që nuk arrimë t'i nxjerrim kuptimet e Islamit, dhe udhëzimet e Kur'anit. Nuk marrim mësim nga të tjerët të cilët shfaqin ambicie, iniciativë e vendosmëri në atë që zbulojnë përvojat e jetës. Kemi shembuj të ndryshëm të dijetarëve të cilët e flijuan veten në rrugën e dijes, krejt kjo është rezultat i qëllimeve të caktuara nga ta qysh herët.

Përveç kësaj, ndonjëherë njeriu habitet me bukuritë e kësaj bote e mendon se instanca e fundit është kjo botë, kur në fakt kjo botë është vetëm fillimi.

Njeriu duhet të kuptojë se vetëm duke pasur qëllime nuk e ka suksesin e siguruar por thjesht ia lehtëson vetes rrugën, përveç kësaj ia bën të qartë njeriut aspiratën në të cilën është vendosur, dhe i bën më të lehta shmangien e pengesave.

Synimi i përpjekjes duhet të jetë bota tjetër, ashtu sikur na ka porositur Allahu xh.sh.

“Por përpiku me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë.

Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu.” (Kasas, 77)

Një studim nga universiteti Harvard, ka zbuluar se nga 3% e studentëve të cilët ishin të përcaktuar në qëllimet e tyre, fitonin 10 fish më shumë se 97% e studentëve të gjithë bashkë, vetëm 10 vjet pas diplomimit.

Ambicia si fjalë, është shpesh e përdorur, por shumë pak e kuptuar. Kemi rastet kur sahabët, shokët më të ngushtë të Muhamedit s.a.v.s e vlerësonin njeriun me ambicie, sikur që:

Thotë Omeri r.a: “Mos i zvogloni ambiciet tuaja, sepse s'kam parë njerëz më të ulët sesa ata që i zvoglojnë ambiciet e tyre”. Thotë Prijësi i besimtarëve Aliu r.a: “Bëhu burrë që e ka këmbën në baltë, ndërsa e ka ambicien në qiell”.

Njerëzit ambicioz kanë mundësi të lënë pas dore disa gjëra, të cilat nuk i shohin në lidhje direkte me temën e ambicieve të tyre, siç janë disa obligime familiare dhe të fafesisit. Njeriu që bjen në këtë gabim duhet ta përmirësojë veten, poqëse s'mundet ma shumë, atëhere aq sa i largon nga ai qortimet e qortuesve. Mençuri dhe zgjuarsi është aftësia për të vënë qëllime, për t'i përcaktuar ato dhe për tu angazhuar për jetësimin e tyre. Nëse dëshiron shtytje në vetëbesim, ja ku ke disa këshilla:

- Përgadite vetën me arritjet që dëshiron t'i kapësh në të ardhmen e afërt.

- Bërja e duave, ngase duaja është arma e besimtarit.

- Shtimi i adhurimeve shtesë perveq farzeve, sikur namazet nafle.

- Buzeqeshtja mes shoqërisë.

- Sadaka

- Dhikri

E që përveç këtyre kemi shembuj të ndryshëm e të shumtë se si ta arrimë qëllimin.

Ndoshta mund të duken gjëra të imta, dhe ne kemi vendosur ambicie goxha të larta, e mendojmë se nuk do arrimë diçka me to, kur në fakt është krejt e kundërta, pasi që kur një veprim i vogël por i hajrit përsëritet, do vërejmë ndryshime të mëdha krejt në fund. E kurrsesi mos mendo se je vonë që të ndryshosh, vetëm duhet të vendosesh seriozisht dhe të kapesht për idenë tënde.

Njeriu ambicioz padyshim duhet të vazhdojë në veprat që vazhdojnë dhe nuk ndalen. Ky njeri duhet të përkujton se:

“Vepra më e dashur te All-llahu është ajo që është e vazhduar edhe pse është pak”.

E gjithë jeta e Pejgamberit tonë të dashur ka qenë me optimizëm dhe me ambicie të larta, sjellje me të cilën i ka edukuar shokët e tij dhe ata që do të vijnë pas të jenë prej ambiciozëve.

E lusim Allahun të na bëjë prej njerëzve me ambicie të larta, të na bekojë kohën dhe punën tonë, të na pranojë lutjet tona e të na bëjë të suksesshëm në jetën tonë.

Harith Abazi 12/2

Ruaje pagen në shpirtin tënd edhe kur bota e prish atë!

Cdo mëngjes ne zgjohemi dhe na është bërë shprehi të kontrollojmë telefonin posa të hapim sytë. Ne kontrollojnë për të parë, se çfarë po ndodh në botën e jashtme. Shohim shoqërinë tonë, njerëz të huaj, madje shohim edhe njerëz që nuk i pëlqejmë. Më pas, shohim se çfarë aventura të mrekullueshme kanë bërë miqtë tanë e jeta e të gjithëve na duket e përsosur.

Shpesh herë ne, jetën tonë e krahasojmë me jetën e të tjerëve që shohim në internet, dhe më pas na kaplon një lloj mërzie, një lloj trishtimi përbrenda. Ne fillojmë të mendojmë se si mund t'i maskojmë këto ndjenja dhe të portretizojmë një jetë të lumtur.

Interneti dhe rrjetet sociale në përgjithësi, na kanë bërë pak të fiksuar me kompleksin e të pasurit një jetë të përsosur dhe kur ne ndihemi sikur jeta jonë nuk është perfekte, bëhemi të pakënaqur dhe në kokën tonë ka shumë mendime dhe pavëmendshëm ne pyesim vetëvetën pse ne ndihemi kështu?! Njëra prej tyre është fakti se, po harrojmë se kjo jetë nuk është menduar kurrë të jetë e përsosur. Secili prej nesh në klasë, secili prej nesh në këtë botë, është testuar në një mënyrë apo tjetër, e dikush mund të pyes, se pse po i them këto fjalë me një vetëbesim të tillë?!

Ngase Allahu i Lartëmadhërishtëm e ka bërë shumë të qartë se kjo botë nuk është Xhenet. Tani çfarë është frika dhe nga ç'ka ne në realitet frikësohemi? Frika është një emocion dhe Allahu i Lartëmadhërishtëm do të na testoi me emocionet tona dhe më pas përmendi të gjitha gjërat që mund të na bëjnë të ndihemi të pikëlluar apo të shqetësuar.

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepju përgëzim durimtarëve” (El-Bekare, 155)

Pikërisht me këtë do të na testojë Zoti ynë. Por, më pas, Ai neve na jep shpresë dhe thotë jepni lajme gëzimi, sihariq durimtarit. Në të njëjtën kohë ndodh që shejtani na mashtron dhe biem pre e cytjeve të tij dhe ai na thotë, na bindë që nëse ne ndjejmë emocione të tilla kjo do të thotë se ne nuk kemi besim, ose na bënë të kuptojmë se Allahu është i zemëruar me ne, e kjo nuk është e vërtetë.

Trishtimi dhe ankthi janë pjesë e kësaj jete. Ato janë emocione të natyrshme që Allahu krijoi tek ne këto ndjenja, ku një shkallë e caktuar e këtyre emocioneve ekziston në secilin prej nesh, gjë e cila është krejtësisht normale.

Allahu xh.sh. krijoi një gamë të gjerë emocionesh, të cilat secili prej nesh do t’i përjetojë ku edhe të Dërguarit, paqja dhe bekimi qofshin mbi ta, përjetuan dëshpërim dhe ankth. Kam veçuar disa raste nga jeta e të Dërguarve dhe jeta e disa njerëzve të veçuar që e sqaron këtë gjë:

1. Kemi rastin e Jakubit a.s.. Ai ishte aq i mërzhitur kur u nda nga djali i tij, Jusufi, aq i pikëlluar sa qau aq shumë sa humbi shikimin. SubhanAllah!

2. Dimë se Merjemja a.s. për të cilën i Dërguari jonë i dashur, Muhamedi s.a.v.s. tha se ishte njëra prej grave që arriti ta përsosë besimin e saj, e cila gjerësa po lindte, ishte aq e shqetësuar dhe aq e pikëlluar sa që kishte thënë: “do të doja të kisha vdekur para kësaj dhe do të isha harruar prej kohësh” Merjem, 23.

3. Ne madje e dimë se edhe i Dërguari ynë i dashur s.a.v.s. përjetoi pikëllim në jetën e tij, ku kishte kaluar një periudhë të rëndë përjetimesh, në jetën e tij, të quajtur *Âm al-Ḥuzn* (viti i pikëllimit).

Dhe kur ne përjetojmë momente lufte, duhet të kujtojmë, se Allahu na urdhëroi që të ngrejmë kokën lartë dhe na tregoi se do të sprovohemi gjatë kësaj jete, por merreni me mend se çfarë tha Ai në të njëjtën kohë:

“All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij..” (El-Bekare, 286)

Kështu që, dijeni se ju jeni të forta, ti je e fortë dhe se Allahu po na thotë se ne mundemi të kapërcejmë çdo sfidë që na del përpara! Fakti për këtë gjë është se, neve na janë vëndosur këto sfida, sepse Ai e di që ne jemi mjaft të fortë për t’i tejkaluar ato dhe se ne shpeshherë i nënvlerësojmë aftësitë tona. Allahu e di më së miri se si Ai na krijoi neve deh se ç’farë ne në realitet mund të përballojmë.

Nga fakti që ne ndonjëherë e gjejmë veten duke krahasuar jetën tonë me të të tjerëve, atëherë e shohim veten të pavendosur në vendimet që marrim. Kjo na bënë që të ndihemi të humbur në jetë. Të ndihesh i/e humbur në jetë, e i pllakosur të bënë të mendosh se nuk ke askënd pranë vetës, gjatë sprovave apo sfidave që ti po kalon. Na bënë të harrojmë se Zoti është pranë nesh.

“Kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua” (El-Bekare, 186). Pra, Ai, Allahu është afër nesh dhe ndëgjon hallet e preokupimet tona edhe kur ne ato nuk dijmë t’i artikulojmë e as t’i pëshpërisim.

Rezultat i gjithë kësaj teme është, se ne duhet t’i shikojmë aspektet më të shndritshme të jetës sonë para se t’i shikojmë anët e errëta të saj, dhe nëse ju ndiheni të humbur në jetë dhe të pashpresë, kthehuni tek Allahu sepse Ai është me ju: “Mos e humb shpresën e as mos u trishto” (Ali Imran, 139)

Era kurrë nuk mund ta lëvizë malin, por ajo luan me rërën dhe i jep asaj format që dëshiron, kështu që le të jetë Kurani formësuar i jetëve tuaja!

Ruani mendjet tuaja sepse ato janë amanet nga Allahu tek ne dhe Ai do të na pyes për to. Unë lus Allahun xh.sh. me emrat e Tij të bukur dhe atributet e Tij të përsosura për ta bërë Kuranin shërues për të gjithë ne. I lutem Atij që ta zëvendëson trishtimin tonë me lumturi dhe gëzim dhe shqetësimin me qetësi shpirtërore. I lutem Atij që ashtu si na mblodhi të gjithë këtu sot që të na mbledhë të gjithëve në Xhenet me të Dërguarin s.a.v.s

Elsa Llalloshi 12/4



KLASA 10/1
KUJDESTAR **EKREM MAQEDONCI**



KLASA 10/2

KLASA 10/2
KUJDESTAR **DRITON ARIFI**



KLASA 10/3
KUJDESTAR **HYSNI BEKA**



KLASA 10/4
KUJDESTARE **HATIXHE JASHANICA**



KLASA 10/5
KUJDESTAR **SAMIR AHMETI**



KLASA 11/1
KUJDESTAR **ADNAN SIMNICA**



KLASA 11/2
KUJDESTAR **KUJTIM JASHANICA**



KLASA 11/3
KUJDESTARE **SHAHË MEMISHI**



KLASA 11/4
KUJDESTARE **LULJETA AVDIU**



KLASA 12/1
KUJDESTAR **SHKËLZEN HOXHA**



KLASA 12/2
KUJDESTAR **MUHARREM TËRNAVA**



KLASA 12/3
KUJDESTAR **BRAHIM ALIU**



KLASA 12/4
KUJDESTARE **VALBONA ASLLANI**

MANIFESTIMI I DITËLINDJES SË MUHAMED MUSTAFASË NË MEDRESENË ALAUDDIN

Në ambientin e shkollës “Medreseja Alauddin” në Prishtinë u mbajt një program me rastin e ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut, Muhmedit a.s.

Programi filloi me një lexim të një ashereje (ku flet për Pejgamberin a.s.), e cila u lexua nga nxënësja Esma Curri.

Pastaj programi vazhdoi me një fjalë rasti nga drejtori i shkollës, Mr. Fadil Hasani, i cili theksoi shëmbëlltyrën e Pejgamberit a.s., lindjen dhe ardhjen e tij në këtë botë për të qenë mëshirë, dëshmuar, udhëzues, lajmëtar dhe kandil ndriçues për mbarë njerëzimin. Më tej, shtoi se populli ynë është krenar që i takon fesë hyjnore, Islamit dhe që jemi pjesë e ummetit të përzgjedhur të Muhammedit a.s.

Ky fjalim u përcjell me salavate për më të dashurin e Allahut dhe më të mirin e njerëzve, të kënduara nga ana e korit të vajzave të Medresesë.

Fjalimin kryesor, se përse kremtohet mevludi - ditëlindja e të Dërguarit a.s., e pati profesori i historisë islame Samir Ahmeti, për të rikujtuar dobitë dhe përfitimet e shumta që dalin nga shënimi i ditëlindjes së Muhmedit a.s., siç janë: shprehja e dashurisë ndaj Pejgamberit a.s., këndimi i salavateve, kujtimi i ajeteve kur'anore se ai që e do Allahun, ai e do edhe Pejgamberin, pason atë dhe fiton dashurinë dhe faljen e Allahut, etj.

Nga thesarët e këtij programi ishin edhe angazhimet e nxënësve në mënyra të ndryshme. Para pjesëmarrësve u paraqit një video në lidhje me jetën e Muhmedit a.s., të përgatitur nga nxënësi Emir Mehani, pastaj edhe një ilahi e kënduar nga kori i vajzave të Medresesë, që përshkruante shëmbëlltyrën e dashurisë, të Dërguarin e Allahut.

Dhe për të sinjalizuar fundin e kësaj ëmbëlsie madhështore të një dite me rreze ndryshe prej herave tjera, nxënësja Lejla Salihu interpretoi poemën “Fleta e bardhë” të shkruar nga nxënësja Esma Curri.



PROMOVIMI I ROMANIT “EDHE QIELLI QAU!”

Endikuar dhe e preokupuar nga ngjarjet e fundit, lidhur me trajtesën e femrës në shoqërinë tonë por edhe në mbarë botën, nxënësja Esma Curri nga klasa 12/4 morri guximin të shkruajë dhe të përcjellë mesazhe të forta në lidhje me këtë temë. Andaj, si përgjigje e thirrjes së saj u bë edhe stafi i ShML “Medresesë Alauddin”, të cilët me mbështetjen e tyre realizuan promovimin e këtij romani.

Promovimi u mbajt me 29.03.2022 në orën 15:00 në amfiteatrin e shkollës. Programi filloi me lexim të mrekullueshëm të fjalës së Allahut nga nxënësja Enida Kajtazi.

Më pastaj drejtori përshëndeti të pranishmit, uroi autoren, Esma Curri për librin e shkruar, duke e cilësuar atë si produkt të imagjinatës së një shkrimtareje, romanciere të re, që sjell tek ne një zhanër tjetër në vijimësinë e disa librave autorial nga nxënësit/et paraprak/e. Drejtori gjithashtu shprehi gatishmërinë e tij dhe përkrahjen e plotë të tij për nxënësit kreativ edhe në të ardhmen.

Më pas, fjala i'u dha redaktorit të librit, prindit të nxënëses, dhe kujdestares së klasës 12/4, Valbona Asllani. Me ç'rast kujdestarja falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, drejtorin dhe të gjitha shoqet e autorës për këtë organizim. Poashtu ajo shprehu ndjenjat, lumturinë dhe krenarinë e saj për të gjitha arritjet e të gjitha nxënësve në të gjitha fushat.

Me një shkëputje të shkurtër nga libri “Edhe qielli qau!”, nx Lejla Salihu, para shikuesve, në skenë solli një fragment me një lexim të bukur artistik.

Programi u mbyll me ilahinë “Këndo oj zemra ime” nga nxënëset Enida Kajtazi dhe Lindita Makolli.



SHËNOHET 70 VJETORI I "MEDRESESË ALAUDDIN"

Me intonimin e Himnit Kombëtar dhe atë Shtetëror, në mënyrë solemne është shënuar 70 vjetori i themelimit të ShML"Medreseja Alauddin". Në këtë manifestim që u organizua nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe ShML"Medreseja Alauddin", morën pjesë: Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, ish-President i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, përfaqësuesi i Presidentes së Kosovës, z. Bekim Kupina, Ambasadori i Republikës së Turqisë, Çağrı Sakar, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane z. Dominik, Kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, drejtori i Institutit Albanologjik, z. Hysen Matoshi, drejtori i Institutit të Historisë, z. Sabit Sylja, drejtori i Shoqatës së ish-burgosurve politik, z. Selatin Novosella, drejtori i medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim Idrizi, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale të vendit, drejtues të institucioneve të Bashkësisë Islame, ish-drejtorë të Medresesë, profesorë, pedagogë dhe personeli i Medresesë.

Mysafirëve u dëshiroi mirëseardhje drejtori i Medresesë, z. Fadil Hasani, i cili i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e këtij manifestimi dhe çmoi kontributin e shkollës të dëshmuar përgjatë viteve, qoftë në



rrafshin fetar edhe atë kombëtar. Ai më pas theksoi, se Medreseja ishte gjithmonë në shërbim të fesë dhe të atdheut, duke kultivuar hoxhallarë, ushtarë, policë dhe shumë profesione të ndryshme.

Këtë manifestim e përshëndeti edhe Myftiu Tërnavë, i cili Medresesë i uroi nga zemra jetë të gjatë, suksese dhe veprimtari të begatë, si dhe përmbushje të plotë të misionit të saj hyjnor, historik e kombëtar. Ai më pas tha, se kjo Medrese ishte e para në të gjitha trojet shqiptare, e cila funksiononte vetëm në gjuhën shqipe. Tërnavë tha se fati i Medresesë është i lidhur ngushtë edhe me fatin e popullit shqiptar, sidomos në luftën e fundit në Kosovë.



Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, tha se besimi shërben si direktivë për çdo hap të jetës.

Ne duhet ta mirëmbajmë veten tonë si shembull për harmoni ndër fetare, shembull për demokraci dhe shembull që besimi dhe tradita fetare, çfarëdo qofshin ato, mund të përjetohen në mënyrë origjinale edhe në kohërat moderne. “Unë e di që sot, më shumë se një shekull pas, mes medresistëve këtu, ka nxënës po kaq të shkëlqyer dhe edhe më shumë të përkushtuar për dije. Leximi në formë urdhërore si fjala që hap tekstin e Kuranit dhe këshilla e Muhamedit për të kërkuar dijen deri në fund të botës, besoj se janë motiv nismëtar për medresistët këtu, bashkë me synimin për emancipim dhe kontribut dhënie në shoqëri. “Si një popull me shumicë myslimane, shqiptarët ditën ta ruajnë Islamin mes tyre edhe gjatë këtyre dy dekadave të fundit, kur për shkak të luftës globale kundër terrorizmit, të ishe mysliman, ishte e vështirë, sikur ta mbaje një gacë në dorë, saktë siç kishte parashikuar profeti i islamit, Muhamed.

Këshilltari i presidentes Osmani, z. Bekim Kupina, në emrin e Presidentes Osmani, përcolli medaljen presidenciale të meritave, medaljen “Për liri dhe pavarësi” për Medresenë “Alauddin” për kontributin e dhënë ndër vite. “Muret e këtij objekti janë dëshmitarë të kohës së një pjese të lavdishme të historisë sonë, ku në këtë vatër diturie, mësimi dhe aktiviteti kombëtar ishin bërë një. Në këtë përvjetor, Medrese-

Kryetari i AKR-së dhe ish-Presidenti i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, në një fjalë rasti, ka uruar suksese të mëtutjeshme shkollës së mesme. “Ju mësimdhënës, akademikë të këtij tempulli, na keni mësuar si të jetojmë, si të sillemi me njëri-tjetrin, si ta duam njëri-tjetrin”, tha ish-Presidenti Pacolli.

“Medreseja Alauddin” i nderoi me mirënjohje ish-drejtorët dhe disa pedagogë për kontributin e tyre përgjatë historisë së Medresesë në ngritjen dhe avancimin e saj. Me mirënjohje u nderua ish-Drejtori, tani Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ish drejtorët dhe pedagogët, prof. Ekrem Simnica, Bahri ef. Simnica, Jakup ef. Çunaku, Sulejman Osmani, ish sekretar i Medresesë Alauddin në Prishtinë.

Po ashtu mirënjohje ndau edhe Kryetari i të burgosuve politik z. Selatin Novosella, i cili ka zhvilluar aktivitete të shumta në ambientet e Medresesë Alauddin në Prishtinë. Ai tha se gjithnjë e kam theksuar, se kur të shkruhet historiku i Prishtinës, do të jetë i mangët dhe jo i plotë pa përfshirjen e rolit dhe kontributit të Medresesë Alauddin. Kur të shkruhet historia e UÇK-së, posaçërisht ku shkruhet për logjistikën e UÇK-së, nuk mund të merret me mend, se mund të shkruhet par praninë, aktivitetin, sakrificën e Medresesë Alauddin.

“Medreseja gjatë kohës së luftës ka qenë spital, ka pranuar studentët me ditë e netë të tëra dhe i ka strehuar ata, të cilëve u janë djegur shtëpitë dhe UÇK-ja



ja Alauddin, meriton respekt për kontributin që ka dhënë në procesin e lirisë dhe pavarësisë së vendit. Historia dhe kontributi i Medresesë është njëjtë me historinë e shtetit tonë, ajo nuk mund të shihet ndaras. Rol i kësaj shkolle është për t'u admiruar në krijimin e klimës së tolerancës ndër fetare, e cila është e shquar në popullin tonë dhe ajo thjesht nuk është vetëm një shkollë por është një pikë ndalese e secilit prej nesh, monument trashëgimie e një periudhe historike. Kjo Medrese është histori në vete” – tha Kupina.



PROGRAM FESTIV NË SHML “MEDRESEJA ALAUDDIN” PËR NDERË TË FESTËS SË 28 NËNTORIT

Në “Medresenë Alauddin” u mbajt program festiv për Ditën e Flamurit. Programi filloi me disa ajete kuranore nga nxënësi Lind Gllareva duke vazhduar pastaj me himnin e flamurit. Për nder të kësaj feste, nxënësit e kësaj shkolle kanë përgatitur një program të pasur edukativo-arsimor.

Drejtori i kësaj shkolle z.Fadil Hasani, në fjalimin e tij, tha se ngritja e Flamurit në Vlorë nga Ismail Qemali, aso kohe kishte frymëzim dhe motivim të vazhdueshëm nga njerëz të kulturës, dijes dhe si kontribut dhënës ishin edhe hoxhallarët e kohës. Ai i përmendi disa prej tyre, që kanë dhënë kontribut për ngritjen e Flamurit në Vlorë, por para kësaj ngjarje Flamuri u ngrit në odën e Mulla Hys Popovës, që do të thotë se hoxhallarët janë prijatarë në shumë fusha të dijes kombëtare të shkencës si dhe të besimit.

Programi vazhdoi me një video-dokumentar që kishin përgatitur nxënësit për profilet e kontribut dhënësve për ngritjen e Flamurit në Vlorë, me recitalin e përgatitur nga nxënësit e shkollës dhe me ilahitë nga kori i vajzave dhe i djemve.



e ka pasur një adresë, nëse mbyllen të gjitha rrugët dhe shpeshherë janë mbyll, dera e Medresesë ka qenë 24 orë e hapur për neve” - tha Novosella.

Me ilahinë “Drita e Prishtinës” u paraqit lexuesi i Kuranit dhe ish-nxënësi i kësaj shkolle Egzon Ibrahimimi.

Po ashtu, në këtë manifestim, kori i medresesë Alauddin, dhanë një program të pasur kulturo-artistik me ilahi e kaside, si dhe u shfaq versioni i shkurtuar i filmit dokumentar, i përgatitur para 20 vitesh, që trajton historikun dhe kontributin e Medresesë Alauddin ndër vite që nga themelimi.

Krejt në fund pjesëmarrësit patën rastin të shohin ekspozitën me rastin e shënimit të 70 vjetorit të Medresesë “Alauddin” në Prishtinë.

Hadis Gashi 12/1

THËNIET E MATURANTËVE

KLASA 12/1

1. Abdullah Kabashi: "If they say it's impossible, it's impossible for them, not for you"
2. Abdusamed Beqiri: "Rriti fjalët, jo zërin!"
3. Amar Nesimi: "Është e lehtë ta mësosh të vërtetën, por e vështirë të qëndrosh në të".
4. Amir Berisha: Prekëm fundin, por arritëm në maje.
5. Arban Osmani: If you had one ëish, tell me ëhich bredrin you'd bring back. -
6. Ardit Selmani: It's just myself talking to myself about myself.
7. Arian Loku: "Unë e mësova që njerëzit do të harrojnë çfarë ke thënë, njerëzit do të harrojnë çfarë ke bërë, por njerëzit nuk do të harrojnë se si i ke bërë ti ata të ndiheshin"
8. Artin Aliu: Nuk është me rëndësi a fiton apo humbë, me rëndësi është që të kënaqesh duke e bërë atë.
9. Ashkan Qerimi: "Le gjurmë, mos lejo të vdesësh si njëri i thjeshtë!"
10. Behar Ahmeti: Me sjellje të mirë arrin të futesh në zërrat e njerëzve, por pa trokitur e as kërkuar leje...
11. Besart Hoxha: I don't ëant to stand in the croëd. I ëant my oën spotlight.
12. Bleart Cakolli: Diplomimi nuk është përfundimi; është fillimi.
13. Besnik Tërshani: "Ëake up , pray, HUSTLE."
14. Blend Limani: "Kushdo që ka folur keq për mua ja bëj hallall, nuk ja vlen që myslimani të ndëshkohet për shkakun tim"
15. Erson Bajrami: İnsanı hayat değil, ulaşamadığı hayaller öldürür.
16. Florian Miftari: "E mos u mundo shumë për atë brengë, me të vërtetë qetësinë do ta gesh në lutje ndaj Allahut!"
17. Hadis Gashi: I don't alëays knoë ëhat I ëant, but I alëays knoë ëhat I don't ëant. Stanley Kubrick
18. Hamzë Osmani: Mos e mallko errësirën, por ndeze lla- mbën!
19. Harith Gjiko: "Dy fjalë të lehta për gjuhën, të rënda në peshore dhe të dashura tek Rrahmani janë: Subhanallahi ve bihamdihi (i Pastër nga çdo e metë është Allahu) dhe Subhanallahi'l Adhim (i Lartësuar është Madhështori)."
20. Ibrahim Asipi: "Medreseja Alaaddin" vatër e burrave të kombit dhe të fesë.
21. Leart Braba: Prej këshillave të arta të Pejgamberit a.s. me të cilat duhet te jetojmë: "Namazi, namazi"
22. Lind Gllareva: I lig është ai që nuk kërkon shoqëri të mirë, mirëpo më i lig se ky është ai i cili pasi t'i ketë gjetur, i humbë.
23. Muhamed Murati: S'ka eklips për dritën e islamit.
24. Muhamed Sogojeva: Hayat çok kolay ama nasıl kullanacağımızı bilmiyoruz.
25. Rexhep Hajdari: O Njeri, Zoti ta ka fal hundën për të marr frymë, e jo për ta futur në punët e huaja.
26. Rijad Fazliu: Muret kanë vesh, e kanë gojë.
27. Rijad Beka: Mëso të vlerësosh atë që ke, përpara se koha të mësojë të vlerësosh atë që kishe!
28. Rinor Sylja: Allahu e faltë atë që na shanë, dhe e mëshiroftë atë që na lavdëron! Imam Ebu Hanife
29. Ubejd Salija: "Heshtja është pengesa e zgjuarsisë, shfaqë mençurinë te ata që të përfillin dhe të vlerësojnë!"
30. Uveys Smajli: "Allahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfarë)." Surja El-Enfal 33
31. Uveys Ahmeti: Ai që nuk ka bërë asnjë gabim, nuk ka provuar asgjë të re.
32. Valdrin Brahimaj: "Të heshturit ose bartin një brengë të madhe ose një ëndërr të madhe"
33. Zeqir Zeqiri: Diçka e dashur sot, nesër bëhet e urryer dhe diçka e pa pëlqyer sot, nesër bëhet e dashur.

THËNIET E MATURANTËVE

KLASA 12/2

1. *Abdulbasit Bytyqi*: Si të bëjmë durim? Ashtu sikur , kur agjërojmë, e të sigurtë se ezani i akshamit do të thirrë.
2. *Abdurrahman Kida*: "Respekto për t'u respektu!"
3. *Aid Shabani*: "Jeta të sjell sprova, ndërsa sprova bën ta kuptosh jeten".
4. *Altin Behluli*: "Don't be sad because it ended, be happy because it happened".
5. *Amar Lushta*: "I'm bored of being bored because being bored is very boring".
6. *Amir Pajaziti*: "Yesterday I was clever, so I wanted to change the world. Today I'm wise, so I am changing myself". - Rumi.
7. *Andi Muçiqi*: "Jeto në thjeshtësi sa do të jeshë i ngritur dhe mendo për të mirat sado që sprovat janë të shumta!"
8. *Bilal Sinani*: "Te folurit me njerëz është sikur te qepurit, ngase ti je peri dhe fjalet e tua janë gjilpëra. Në qoftëse e rregullon të qepurit mirë, do e bësh një teshë tërheqëse dhe të shtrenjtë. Në qoftëse gabon, atëherë nuk do e lëndosh askënd përveç vetvetes."
9. *Bleron Surkishi*: "E vetmja mënyrë për të bërë punë të mëdha, është që ta doni atë që po bëni."
10. *Ejmen Ternava*: Jeto çdo moment, sikur të ishte i fundit!
11. *Emir Mehani*: "Zoti të dhashtë bereqet n'tru!"
12. *Enes Pajaziti*: "An apple a day keeps anyone away if you throw it hard enough"
13. *Enis Islami*: "Një nga liritë më të mëdha është, të mos interesohesh në të vërtetë se çfarë mendojnë të tjerët për ju."
14. *Ensar Rrahmani*: "You can change what you do, but you can't change what you want".
15. *Erblin Cej*: "Njerëzit e mirë nuk kanë nevojë për ligje, për t'u thënë atyre të veprojnë me përgjegjësi, njerëzit do të gjejnë një mënyrë për t'i anashkaluar ligjet."
16. *Eron Asllani*: You know when they say it has been a pleasure, well it hasn't! Mike Ehrmantraut
17. *Fejsal Ternava*: "Erdha tu menu qe kam me u bo burr, po dal tu kajt si fëmija".
18. *Fidan Neziraj*: "Afër drurit të thatë digjet edhe i njomi, afër njeriut të keq prishet edhe i miri".
19. *Fisnik Dauti*: "I know some people don't like me, but what can I do, not everyone has a good taste".
20. *Fuad Mehmedi*: "Don't marry the most beautiful person in the world, marry the person that makes your world the most beautiful".
21. *Genrit Berisha*: "Lindë një ditë kur do të triumfosh, lindë dita kur do të keshë atë që më së shumti deshe."
22. *Harith Abazi*: "Gjërat e mira marrin kohë, prandaj gjithmonë jam me vonesë"
23. *Ismail Govori*: "Në jetë nuk ekzistojnë zgjidhje, ka vetëm forca në lëvizje: mjafton t'i gjes dhe zgjidhjet vijnë vetvetiu".
24. *Malsor Ajeti*: "E vërteta : rrugën e ka, të gjatë: por vjen."
25. *Muhamed Bajgora*: "See you all at the 10 year reunion".
26. *Musab Hoxha*: "Edukata është ajo që i mbetet njeriut, edhe pasi të harrojë ato që ka mësuar në shkollë"
27. *Nehat Musliu*: "Jeta është një film, skenari i së cilës nuk ia vlen të plotësohet me njerëz të pavlerë".
28. *Rijad Krasniqi*: Kisha dashur të luftojmë me trurët tanë, por më duket se kjo dëshira ime tash për tash gjindet në një ndërtesë të lartë ku shkallët për tu ngritur deri atje janë nga librat dhe mbajtëset janë perdet.
29. *Riad Rrahmani*: "Work until you no longer have to introduce yourself".
30. *Said Kosumi*: "Minds are like parachutes, they only function when open"
31. *Sead Olluri*: "That's the difference between you and me. You wanna lose small, I wanna win big."
32. *Usame Topalli*: "Njeriun e mirë nderojë, njeriun e keq durojë".
33. *Vullnet Baftiu*: "Life is good!".
34. *Yll Krasniqi*: "The pain never really goes away, you just elevate and get used to it by growing strong"

THËNIET E MATURANTEVE

KLASA 12/3

1. Adonita Arifi: "What if this life isn't perfect? This isn't jannah."
2. Aldina Zejnullahu: لا يهيمكم أنت بطيئ طالما أنك لن تتوقف .
3. Amira Osmani: "Take care of your prayers, because one of them will be the last."
4. Amra Kelmendi: "Vitet më të bukura janë vitet e Medresesë"
5. Anisa Osmani: "Everyone is critical of other people's flaës, but blind to their oën."
6. Arbesa Alshiqi: "Afedecek kadar iyi olun, ama tekrar güvenecek kadar aptal olmayın!"
7. Delvina Haziri: "Mos qani sepse mbaroj, buzëqeshni sepse ndodhi!"
8. Dinete Mahmuti: "Ec o i gjallë vrapo, shpejto përpara, sepse më shpejtë se ti vdekja të ndjek nga mbrapa!"
9. Enise Bytyqi: "Nëse Kurani është harta jote, kurrë s'do ta humbasësh rrugën."
10. Esmat Ganiu: "Do not be friend except the person who reminds you of Allah"
11. Fatime Gashi: "Qëndroni me ata që i doni, sepse një ditë nuk do t'i gjeni më!"
12. Florijeta Krasniqi: "Nëse nuk e di që nuk di, kjo është injorancë e dyfishtë."
13. Flutura Xhemaili: "Half of a person's beauty comes from their tongue"
14. Hyrije Sinidolli: "To the girl who chose her Lord instead of this world"
15. Ibadete Morina: "Tërë kënaqësia e përtacisë nuk vlen as sa edhe një çast i vetëm i kënaqësisë së suksesit."
16. Jeta Islami: "Everyone is replaceable, not me tho. Y'all stay safe."
17. Rinesa Zeneli: "Dituria të bën që të dish, që ti nuk din, dhe pa dituri të bën që të mos dish që ti je i paditur."
18. Shqiponjë Shabani: "I ëish there as a day to know you're in the good old days before you've actually left them"
19. Urtina Uka: "They talk about you because if they talked about themselves, nobody could listen!"
20. Vlerona Blenishi: "Unë, numri i fundit dhe po e vendos fjalën e fundit. Tani unë po i fik dritat dhe po mbyll perdet e këtij teatri, se filmi i tre viteve po mbaron përjetësisht, deri në botën e amshueshme."

KLASA 12/4

1. Albiona Podvorica: "Shtojeni kërkim faljen (Istigfarin) sepse me të vjen furnizimi, zgjidhja e problemeve, pasardhësit, dija e dobishme, lehtësimi dhe fshirja e mëkateve!"
2. Ardiana Tashevi: "Koha nuk ndryshon askënd, por zbulon çdo njeri se si është në realitet."
3. Arjeta Jashari: "Kurani është burim lumturie për besimtarin. Sa ke marrë nga kjo lumturi?"
4. Beltina Kamenica: "Humbja e kohës është më e shtrenjtë sesa vdekja, sepse humbja e kohës të largon nga Allahu dhe bota tjetër, e ndërsa vdekja të largon nga kjo botë dhe njerëzit e saj".
5. Besame Jakupi: "Mos lejo që e tashmja në të ardhmen të jetë një e kaluar e hidhur!"
6. Blerta Hoxha: "Ëhere you are is not who you are"
7. Dinete Ibrahim: "Loti që dikur më pikoi nga syri, më pikoi se zemra nuk po ma mbante dot dhimbjen, tani po buzëqeshë, por kjo buzëqeshje është maska e dhimbjes që po ndjej se po largohem nga ti Medreseja ime."
8. Donita Qerimi: "Kam brengën se nuk mora mjaftueshëm nga gjallëria jote, u hutova ndaj të pashmangshmes që çdo agim ka dhe përfundimin."
9. Edona Fetahu: "Kujtoj orët e humbura, të mjafton si këshillë"
10. Elma Murati: "Results of sabr are always beautiful"
11. Enida Kajtazi: "So remember Me, I will remember you." (2:152)
12. Enisa Ajeti: "Një gjethe që ka rënë në tokë, nuk frikësohet nga era."
13. Enise Brahimi: "Allahu shumë njerëzve ua jep këtë botë, por vetëm njerëzve që i do ua jep Islamit"
14. Ermira Musliu: "Mos 'vdis' para se të vdesësh!"
15. Esmat Curri: "Realiteti i jetës nuk gjendet në kolovajzën e ëndërrimeve, por në gatishmërinë tënde për t'u përballur me frikën..."
16. Genta Sadiku: "Njerëzit më serikë janë ata që kurrë nuk qeshin. Vrasësit më serikë janë ata që e vrasin buzëqeshjen. Kujdes me buzëqeshjen!"
17. Hana Hyseni: "Tri vite shkuan, por asnjëherë nuk u harruan."
18. Lejla Avdyli: "The end has come, but here do we start now?"
19. Lejla Salihu: "Neve na zgjodhi Zoti".
20. Lindita Makolli: "Gittim, ardimdan ismimi deçil eserlerimi biraktum."
21. Medina Rrahimi: "If you get tired, learn to rest not quit"
22. Merva Luma: "Kopjo vetëm një gjë: mendjen e profesorëve!"
23. Mirjeta Peci: "At the end of an unforgettable short story. Pleasure"
24. Rinesa Mustafa: "Nëse më pyesin se çfarë grumbullova në këtë vend, u them: përveç dijes, shpirtit t'mirë"
25. Zelihe Musa: "İçimde huzurla karışık bir duygu var".

We don't blame the rain

Your mind traveling beyond usual life, in imagination of your world, until the accident wanted to meet us two.

Maybe, the world wasn't just roses and flowers, because the story was only meant for a few chapters, but little did we know, we needed to be in the whole story.

The eyes were the ones that spoke always with each other, because the words couldn't. Her heart was like a river drowning so fast into her feelings, making sentences in her mind. They had their own world, their own habits, but the only thing that they had together, was the place that they souls meet every night.

Or maybe... it was all the rain that started pouring outside the window, and made all the things impossible.

Even though they tried to keep writing their story, they had to end it here. Their eyes promised that they would stay, but they never said forever. Maybe forever was meant for the memories, not the people.

Jeta Islami 12/3

Sonlar ve yeni başlangıçlar

Çocukluğumuzdan beri "hayatın kuralları"sözünü duyarız insanlardan ve biz büyüdükçe o kuralları tek tek öğretir hayat,ve her kuralı öğrenmenin bir bedeli var.Bu hayatın kurallarından biri de yeni başlangıçlardır. Ve maalesef bu kuralı hayat insana canını acıtarak öğretir.Bu kuralı öğrenmenin bedeli "sonlardır" yani "ayrılıktır" çünkü her son ayrılığı temsil eder.Ama insan şunu unutup ki sonların üzüntüsü birkaç günü, geleceğimiz ise hayatımızı alır. Sana yaramayan şeylere takılma hepsini unut ve hayatımın geri kalanının en güzel yıllarım olmasını dileyerek kendimi yeni başlangıçlara hazırlıyorum

Erson Bajrami 12/1

حبيبتي، الى اللقاء

السلام عليك يا حبيبتي. اليوم أكلمك لآخر مرة، ولكن لا أستطيع أن أقبل هذا، لا يوجد شيء صعب إنه حقيقي، و العكس كان حلوا بنسبة لي. أنا ذاهبة يا الحبيبة، هل تسمعي... ذاهبة، كنت قادمة، و الآن ذاهبة الآن أدخل الصف، أنظر إلى كل شيء مرة أخرى هاذا صفي، أنظر إليه، كم ذكريات لدي هنا! لا أستطيع حساب الابتسامات و الدموع و اللحظات السعيدة...

أنت لست مدرسة فقط، كنت دنيائي، كنت مفتاحا و شفاء لصدري و قلبي. أنا أمشي و أمشي... كل زاويتك لدي شيء، يذكرني، الآن أصبحت ذكريات جميلة لا تحزني، هكذا الدنيا، انها تدور و نحن معها. اليوم نكون و لكن غدا نذهب، و نذهب. يا جميلتي، لا تحزني سلام عليك، و لآخر مرة إلى اللقاء.

Aldina Zejnullahu 12/3

حجابك عنوان عفافك

سَخِرْتُمُ مِنْ عَفَافٍ وَالْفَصْلُ يَوْمَ الْحِسَابِ وَاللَّهُ هُوَ الْحَاكِمُ بَيْنَنَا.

ليقولوا ما يقولوا فليس هناك شيء يحفظ للمرأة كرامتها وعرضها وعزتها مثل الحجاب.

أخيوتي حجابك مصدر عفتك وطهارتك.

حجابك زينتك وللجنة وسيلتك.

حجاب المرأة تاج فوق رأسها، وزينة لها في قبرها، ويوم العرض على ربها.

Anisa Osmani 12/3

لا معنى للحياة دون جدٍ

ها هو العام الدراسي يرحل، ويستعد لإغلاق الأبواب وراء أيام مضت، مضت بكل ما فيها من جدٍ وتعبٍ واجتهاد، مضت بحلوها ومرها، بموادها الدراسية الصعبة والسهلة، بمشاغبات الزملاء، مضت بكل ما فيها، وكأنتها ساعة من عمرنا، لم تأخذ منا إلا القليل، وكأن الأيام تريد أن تخبرنا أنّ العمر ما هو إلا لحظة عابرة، ما إن يطرق الأبواب حتى يغادرنا للأبد، تاركاً وراءه كل الذكريات، فما نحن جميعاً إلا ذكريات عابرة في العمر. ليس من السهل أبداً أن نكسر أسلوب حياتنا فجأة، فبنهاية عامنا الدراسي سنودع طقوس النشاط، والاستيقاظ باكراً، سننسى ولو قليلاً انتظار الحصص الدراسية والمحاضرات، سنشتاق لتوتر الامتحانات، والخوف من العلامات، فمن اجتهد قد كسب، ومن أمضى الأيام مهملاً سيندم، هكذا هي سنة الحياة، فلكل مجتهد نصيب، ولكل شخص فينا طاقة وقدرة، إن استخدمها في العلم والعمل سينجو ويحقق أعلى مراتب العلم، وإن ظلّ كسولاً ومهملاً، سيكون في آخر صفوف الحياة.

من أراد أن يصنع لنهاية العام الدراسي معنى، فعليه أن يجتهد فيه، وألا يضيع وقته في غير ما كان لأجله، وأن يمنحه حقه الكامل، وأن يدرس ويصنع لنفسه مستقبلاً يليق به، فمهما كانت العطلة جميلة، ومهما نعمنا بها بالراحة والمتعة، فلن تكون جميلة إلا إن أتت بعد تعبٍ وجد، فلا شيء في هذه الحياة يأتينا بسهولة، ولا شيء يتحقق بروعة وفخامة، إلا إن كان قد سبقه تعب في الجد، مكللاً بالعمل الدؤوب، والنية الصادقة، والإخلاص في الدراسة.

فلا معنى للحياة دون جدٍ واجتهادٍ وأملٍ بالقادم، اللهم إنا نستودعك عاماً دراسياً مضى، ونستأمنك على عامٍ قادم، فاكتب لنا الخير فيه في كل خطوة.

Amira Osmani 12/3

SELAM TY OJ NANA IME

*Selam ty oj nana ime
Qe m'përcjellë me lot n'sy
Selam ty oj motra ime
O ti drita e syve t'mi !*

*Selam ty o vëllai im
Që të pata krah të djathtë
Selam ty oj nusja ime
Që s'më le pa trashëgim!*

*Pushkën n'dorë, kapa e u nisa
Me luftua për këtë dhë
Që armiku do me marrë
Po Kosovë, emri ka m'i mbet.*

*Deri sa me gjak t'mbulohem
E deri t'jap frymën e fundit
Prej armikut do t'marr hak
Që më djegi shtëpinë dhe katundin*

*Që motrën e dashtun ma kanë dhunu
E që vëllain ma kanë përzënë
Që nusja m'mbeti e ve
E fëmijët jetimë m'i kanë lanë.*

*Oj nanë moj e mjera nanë
Pasha lot e syve tu.
Pasha këtë gjak që lum m'u bë
Lirinë me duart e mia kam me jua pru.*

*Një plumb m'erdhi n'krahbaror
Që m'i la qel sytë e mi
S'ka ilaç që m'i shëron plagët
Përpos fjalës të shtrenjtë "Liri"*

*Për ty oj nanë një amanet
Varrin me lot mos me ma la
Se te Zoti jam shehid
E për këtë dhe unë dëshmor jam ra*

*Ju o populli im i shtrenjtë
Me ruajt këtë atdhe i'u betova
Po mos harroni një gjë për jetë
E jona ishte , është dhe do t'jetë Kosova.*

Sumeja Gashi 11/3



FLETË E BARDHË

E ulur në stolin e vetmisë,
Ndalem e mendoj,
Kjo dashuri e madhe, kur ka nisë,
Po këta lot nga burojnë?
Marrë në dorë lapsin,
Por të shkruaj, nga ta marrë guximin,
Unë e zhytura në errësirën e gjynaheve,
Si të shkruaj për sunduesin e zemrave?!
Mbylli sytë dhe përpiqem...
Përpiqem...
Përpiqem të largohem nga errësira që më kishte kapluar,
E në djersë e mbuluar, imagjinoj shekujt e kaluar,
Atëherë kur drita e Islamit pushtoi e luftoi çdo errësirë,
Atëherë kur Hëna u nda në dysh,
Atëherë kur edhe trangu qau me ikjen e tij,
Atëherë kur fytyra e bekuar u mbulua me gjak,
Atëherë kur emri i tij u njollos me etiketime e gënjeshtër,
E kur zemra e tij u pastrua nga çdo e keqe,
Hapi sytë, shikoj atje lart,
Hëna, varur atje për çdo natë,
Mbetet një bukuroshe e stolisur me dritë,
Flladi i natës përplasë fytyrën time pa frikë,
Yjet kishin zënë vendet e tyre,
E qirinjtë treten ashtu ngadalë,
Po unë, nga kjo humnerë si të dalë?!
Shkrihem e përmallohem për ty Ya ResulAllah!
Ti, o i bekuar, mbolle lulet e dashurisë në zemrën time,
Ti, o baba i çdo jetimi!
Më zgjat dorën e më udhëzo drejt shpëtimit!
Jam një e mjerë, e kam nevojë të shoh pak dritë,
Jam një mëkatare, e kam nevojë për pak mëshirë,
Më drejto!
Më drejto tek Krijuesi im,

Se fjalët u mbytën në harresë,
E zemra po më qanë me dënësë.
Ya ResulAllah!
M'u bë kandil që mposhtë errësirën,
Ashtu siç u bërë për tërë njerëzimin,
Ndërmjetëso edhe për mua tek Allahu,
Që të kem mundësi t'ia shoh Arshin!
Erë misku e shpërndarë kudo,
Vula e pejgamberëve, që çdo besimtar e do,
Sot para 14 shekujve lindi,
E me buzëqeshjen e tij botën ndriti.
Lashë lapsin,
Pa lënë gjurmë në fletë.
Fjalët m'u shterën,
Qirinjtë u tretën,
Ah, sa do të doja,
Të isha Hënë e të bëhesha copë,
E të isha trangu që do qaja për të,
Se si kam rënë në këtë gjendje,
Ti natë dëshmitare je,
E fleta mbeti e bardhë,
Ashtu si shpirti i atij që Islamin përhap.
Edhe sikur të mblidhja lotët e qiellit që bien në tokë,
Nuk do mund t'a përshkruaja dashurinë që kam për ty
E fleta bosh mbeti pa fjalë.
Sa herë ta shohë,
Ty të kujtoj.
Se shiu që ra, i mori kujtimet me vehte,
Diku shumë larg i humbi e i treti.

Jeta Islami 12/3





TRËNDAFILI DHE FERRA

Në një ditë të bukur prilli,
I tha ferrës trëndafili:
Lëshoma vendin t'më qafë dielli,
T'më hyjë drita t'më shoh qielli,
Shih, me gjethe m'ke mbulu,
Si do vijë rrezja tek unë?
Trëndafil lule me erë,
Unë këtu kam ardhur kaherë,
Vend s'të lëshojë pa m'pre sopata,
S'mi shikon rrënjët e gjata?
I'u përgjigj ferra me inat trëndafil, lules n'grat,
Që kish lindur para saj,
N'histori t'kohës me vaj,
Trupi ferrës sapo rritej,
Trëndafil po venitej,
Se skish kush që ta ndihmoj,
Mbi trup ferrën t'ia largoj.

Anisa Bytyçi 11/3



NJERIU -NJERIUT

Kush je ti t'ma zësh lirinë rob,
Kush të dha leje për të shkel n'këtë komb,
Kush të thotë që jeni zotni
Të këqij do mbetni, n'përjetësi.

Kush t'dha leje t'ma marrësh rininë,
Kush t'dha leje t'ma djegësh shtëpinë,
Kush të tha t'ma mbyttësh shpresën,
Njeri i ligë, të marrësh jetën.

Armën kujt ju ia drejtuat,
Mrrolët kujt ju ia lëshuat,
Deri kur ju i përndjektë,
Zemrat e lira me dry i mbyllët,
Tokën e kujt donit ta merrnit,
Gjakun e kujt donit ta derdhnit,
Shtëpinë e kujt e bombarduat,
Nga mëmëdheu kë e dëbuar?

Trupat si kukulla i trajtuat,
Dheu i Reçakut u mbush me burra,
Gra e fëmijë u masakruan,
A mendoni se u harruan?!

Vendin kujt ju ia shkatërruat,
Familjen kujt ia masakruat,
Kujt ia mbushe sytë me lot,
E kaluara thërret, më harro!

Jo, jo, asnjëherë,
E kaluara gjithë do mbahet nëmend,
Se tokën tentuan t'ma vjedhin,
E emrin shqiptar t'ma tretin.

S'jam i mjerë, e as i marrë,
S'jam frikacak e as tradhtar.
Nuk luaj me nder e me liri,
Se në ballë kam të shkruar, emrin njeri.

Mirjeta Peci 12/4

RAMAZANI

*Erdhi ky muaj, muaji Ramazan
Fytyrat na buzëqeshin, zemrat plot iman
E kush prej juaj këtë muaj e përjeton
Le të agjërojë, shpirtin ta pastrojë*

*Të presim o i dashur, me mallë të presim
Zemrat të na i pastros, fytyrat të na i ndriçosh
Myzhde për ju, që e arritët këtë muaj
Myzhde, ju me të vërtetë keni fituar*

*Ezani po thërret, etjen që ta shuajmë
I themi njëri-tjetrit "agjërim të pranuar"
Duart ngrisim lart, loti rrjedh ngadalë
Na e mundëso o Zot, të hyjmë në Rejjan!*

*Po thërret ezani, në xhaminë e lagjes
Plakut e të riut, zemra iu kënaqet
Në namaz të teravive, ejani të shkojmë
Ejani o vëllezër, Xhennetin t'a fitojmë!*

*E këtë muaj t'bekuar, me Kuran ta kalojmë
Natën e Kadrit, në dhjetëshen e fundit ta kërkojmë,
Në netët e gjata, namazin ta shtojmë,
E pritshim këtë muaj, aq gjatë sa do t'rrojmë!*

Said Kosumi 12/2

DITURIA

*Dituria është dritë
Dituria është udhëzim
Ajo është fitore
Ajo është Shpëtim*

*Njeriu pa dije
Jeton në errësirë
Jeton i robëruar
Nuk ndihet i lirë*

*Porosia ime është
Që ne të mësojmë
Të ecim përpara
E të triumfojmë*

Amar Krasniqi 11/1



ECI MENDUESHËM

*Eci rrugëve të qytetit,
Herë me kokën lart,
E herë me kokën poshtë,
Nganjëherë i shoqëruar
E rrallë herë i vetmuar.*

*Eci duke menduar,
Mendoj e imagjinoj,
E më së shumti, kujtoj
Kujtoj kohët kur isha fëmijë,
E lozja me top, duke dalë "n'qarsh.*

*Sa shumë më mungojnë ato ditë e ajo kohë.
E quaj kohë e artë se vetëm atëherë,
Ne si fëmijë luanim me dëborë.*

*Duke ecur shoh shumë njerëz,
Disa të pa njohur e të tjerë të njohur,
I përshëndes, se dikur i quaja shoqëri
Tani për çudi sillen sikur e kanë mërzi.*

*Më pas duke ecur
Në mendje më lind një pyetje*

*E kjo pyetje që po m'qarkullon
Nganjëherë edhe po mshqetson.
Por prapë them : jo
Se unë kam vendosur;
Njeri i tillë kam ardhë
Dhe i tillë do të iki nga kjo botë.*

*Më pas shoh dikë që mshah me habi,
E unë them: vallë ç'pati?!
Mos vallë ju ngatrhoa,
Apo mos pa dashje e lëndova.*

*E lëndova se i kujtova dikë,
Apo vetëm shikon si për qudi,
Se për njerëzit është bërë shprehë.*

*Më pas, më kap syri disa njerëz
Që mundohen të sillen perfekt,
Thua se janë intelekt.*

*Mundohen të paraqiten si dikush,
E si përfundim mbesin askush.*

*E më pas ndjej krenari me veten,
Se kam një arritje për lakmi,
Ama jo të gjithë e quajnë të tillë.*

*Edhe pak hapa jam afër shtëpisë,
Afër qetisë e lumturisë.
Buzëqesh sepse e di që familja po
m'pret
Po m'presin mua me ardhë,
Se nuk ka kush shaka me i'u thanë.
Sa mirë, afër shtëpisë kam xhaminë.
E sa herë që kaloj, gjithmonë ma
kujton
Se është Dikush atje lart që na shikon,
E shumë plane të mira për ne
planifikon.*

*E kështu duke menduar unë
Përfundova të ecurit në qytet.
E si përfundim unë do t'ua them:
Kam zgjedhur të jem unë
Ai që duhet të jem.*

Andi Muçiqi 12/2



EMRI

*Kohët e kaluara,
Kohë të pambaruara.
Dëshirë e zjarrtë,
Dëshirë pa asnjë pakt.*

*Jeta ime paska pak vlerë,
Kur mendoj për atë që ndjej,
Jetë që numërohet në ditë,
E këtë se paskam pritë.*

*Po ta dinin historinë e vërtetë,
Do të vajtonin ditë e natë.
Ndodh ajo që nuk e pret,
E kjo është ajo që duhet të jetë.*

*Çdo natë lotët dalin ngadalë,
Shoh zjarrin në zemër.
Njerëz të përdalë,
E kjo dhimbje a ka emër?!*

Muhamed Sogojeva 12/1

MEDRESANT

*Fillova një jetë të re, në Medresenë e vjetër
Shoqëria e medreses, është si asnjë tjetër
Me kënaqësi qëndroja në bankat e shkollës
Ndëgjoja profesorët, teksa nxirrnin mjaltë prej gojës
Koha në medrese, kalonte pa përshkrueshëm
Teksa ne mësonim, për Allahun e Madhërishëm*

*Me mendje shpesh kthehem e qëndroj në Medrese
Kthehem në lëndën e historisë
Kur ne na mësonin për Vulën e Pejgamberisë
Orët e Kur'anit, kalonin shpejt si era
Mësojmë fjalën e Allahut, Kur'anin me shumë vlera.
Me ndihmën e Allahut, Medresenë përfundova
Por me mendje gjithmonë, unë aty qëndrova
Profesorët e dashur në rrugën e dijes shërbejnë
Na nxjerrin gjenerata, të cilat shkëlqejnë
Prandaj Medreseja ka shumë nxënës,
që vijnë pa u ndalë
I thërras me gjithë zemër: eja Medresant!*

*Medresant plot me nur
Mësoje Allahun El-Gafur
Medreseja është për të gjithë një vatër
Duhet të mësosh me shumë sabër
Ne këtë jetë jemi kalimtarë
Vetëm Allahu është Ngadhënjimtar*

Fuad Bajrami 11/1

KRYETRIMIT TË LUGINËS

(Ridvan Qazimi-Komandat Lleshi)

*Ti krenari e Luginës martire
Ta kurdisë belan katilët barbarë
Dhe në pabesi të vranë.*

*Ti ishe Shqiponjë atdhetare
Që fluturonte nëpër qiell pa u ndalë
Armikun me luftuar
Luginën për ta çliruar.*

*Për tokën tënde punove pa ndërprerë
Negociatat i udhëhoqe si një burrë i madh
Në UÇPMB ishe gjithmonë i pari
Ti komandat Lleshi, o legjendar.*

*Veprat e tua do t'i kujtojmë ne
Lugina e kombi i mbarë.
Tash më t'kanë ngritur lapidar lirie
Komandat Lleshi, o dëshmor shqiptar.*

Anis Banjska 10/1

SA MË QETËSON!

Sa më qetëson një falë,
Që del si një krrua, e mbushur me dashuri;
Sa më qetëson një buzëqeshje,
Nga një fytyrë që është e mbushur me dritë;
Sa më qetësojnë ca duar,
Që përqaftimin presin me mall;
Sa më qetësojnë ca nalle
Teksa ecin për t' më parë;
Sa më qetëson aroma,
Që posedon erën më të veçantë;
Sa më qetësojnë sytë,
Që shikimin nga unë e kanë;
Sa më qetësojnë veshët e saj,
Që çdo tingull timin dëgjon;
Sa më qetëson dashuria e saj,
Që asnjëherë s'më keqkupton;
Sa më qetëson fakti,
Që edhe mimika e fytyrës i njeh,
Pa fol goja fare,
Gjendjen time ajo sheh;
Sa më qetëson kjo miqësi,
Që nën hijen e Allahut do të jemi,
Në atë ditë ku hije tjetër s'ka
E ne aty do të vemi.
Motra ime e dashur
Vet prezenca jote është qetësi për mua,
Andaj me plot shpirt të them
Për Allah të dua!

Blerona Qerimi 12/3



SHQIPËRIA IME

Shqipëri moj Shqipëria ime,
O vend i bukur dhe i bekuar,
Moj Shqipojnë bukuroshe
Përse nuk buzëqesh njëherë për mua?

Ç'ke që je mërziur dhe e pikëlluar,
Dukesh e lodhur dhe e dërmuar,
Ku të mbeti bukuria moj Shqipojnë,
Nëse të humbi, mos u shqetëso!
Thjesht hapi krahët dhe fluturo!

Oj Shqipojnë, merr forcë e fuqi,
Lufto armiqët e tu gjerë në veri!

O vend ku lindin trimat,
ku këndojnë vashat e bukura
lavdëruar qofsh sa tjetër jeta!
Enis Krasniqi 11/1



TË DUA MËMËDHE

Të dua ashtu si je
O i dashur Mëmëdhe,
Dashurinë për ty të thellë
Zoti në zemër na e ka mbjellë.

Sot Pavarsinë ta kremtojmë,
Nxënësit e shkollës sonë
Jetë të giatë të dëshirojmë,
Shqipëri o Mëmëdheu jonë.

Prej teje të ndarë
Me zemër të vvarë
Gjithmonë krenarë
Që jemi Shqipëtarë.

Abdullah Asipi 10/1

ZEMRA IME

*Zemra ime zgjedhi të qëndroj këtu
Nuk ishte një teke, thjesht ashtu
Këtë vend ajo e dashuron
Edhe kur të vdes, nuk do ta harron*

*Moj Medreseja ime e dashur
Ke qenë vatër diturie për breza të tërë
Sa e sa perla të diturisë ke pasur
Asnjëherë s'do t'harrohen të mirat që ke bërë.*

Arlind Sopu 11/1



RAMAZANI

*Filloj Ramazani, erdhi bereqeti
Atmosferë e bukur, u gëzua Umeti*

*Ditën ligjërata, imani po shtohet
Në sofrën e iftarit, familja bashkohet*

*Natën teravia, u mbush dhe xhamia
Safetë janë renditur, shtohet dashuria*

*Plaku dhe fëmija, gjithmonë të hareshëm
Ta nxënë safin e parë, sfidë e përhershme*

*Leximi Kuranit, përmendja e Allahut
Sot po i buzëqeshet, vëllai- vëllait*

*Syfyrr me familje, jep shumë harmoni
Dritat janë të ndezura, nuk ka gjumë në sy*

*Dhjetet netët e fundit, ibadet pa ndalë
Kërkojmë Natën e Kadrit, dalim faqebardhë*

*U shtua Istigfari, fillon të rrjedhë loti
U mërzi myslimani, na faltë Mëshirëploti*

*O rob i Allahut, ti që agjërove
Mos e humb kurrë shpresën, sepse ti fitove
Erdhi dhe kjo festë, gëzim për myslimanët Urimi
i Bajramit, thirret nga katër anët.*

Muhammed Asllani 11/2

MIKES TIME

*Motër, që dhimbjen ma kupton,
Dashurinë kurrë nuk e kufizon.
Që për mbrojtje tepër të kam nevojë,
Se sa të dua veç Zoti e kupton .
Sa herë më je dashur ,
Pranë të kam parë,
Sa herë më je dashur ,
Motër m'u ke bërë,
Sa herë më je dashur ,
Dhimbjen bashkë kemi ndarë,
Sa herë më je dashur,
Kurrë nuk ke munguar,
Me fjalët e Allahut,
Zemrën ma ke lehtësuar.
E ditë e natë për ty bëj dua
Që Allahu në hijen e Tij
Për ne të bëjë zë .
Të bëjë zë që ne të flasim,
Për problemet tona
Njëra-tjetrës t'i flasim.
Më tepër e di për çka e dua at zë?!
Për t'i kujtuar Allahut veprat që për mua ke bë.
Edhe nëse pjesë e Xhenetit të mos jesh,
T'i kërkoj Allahut, larg teje të mos më lë!*

Blerona Qerimi 12/3



TI NDJENJË E BUKUR...

*Fshehu, t 'ludem,
Fshehu n 'erën e luleve, e unë çdoherë do t'i nuhas;
Fshehu n 'shiun e rrëmbyeshëm t'verës, e unë çdo pikë të tij do
ta ndje;
Fshehu n 'dritën e hënës, e unë Hanën çdo natë do e pres;
Fshehu n 'muzgun e errët t 'natës, e unë zgjuat kam me qenë;
Fshehu n 'zemrat e njerëzve, e unë njerëzit do t'i mirëpres!
...
Fshehu ku të duash, mirëpo mua mos më le!
Fshehu, t 'ludem, fshehu aty ku unë të gjej!*

Adonita Arifi, 12/3

LEXO!

*Kush e kthen monotonin
në dëfrim,
Kush nuk na tradhton asnjëherë,
Kush nuk të përhap
sekretin tënd,
Cila dritë na udhëheq
drejt qytetërimit,
Cila anije na bart në
çdo vend,
Me çka krenohet i dituri,
e padyshim për këto pyetje
Përgjigje është libri.*

*Dëshiron të gesh dritë
në errësirë,
Të gesh dituri pa kufi,
Të kesh fjalë me flori,
Të jesh i singert,
Të kesh zemër të vërtetë,
Të kesh një mendje
Plot pastërti,
Të mundësh injorancën,
Të jesh i lirë,
Të jesh i mirë,
Tek ti të ketë lumturi?
Atëherë zbato fjalën magjike:
Lexo!!!*

Andi Muçiqi 12/2



PRESHEVËS SIME

*Presheva ime
S'mundem me tharru
Në ty po kaloj jetën
Sa fort që të du .*

*Preshevë moj qytezë e bukur
Gjithmonë të kam në zemër
Më bën krenar
Më ke dhënë të bukurin emër.*

*Preshevë, ti na dha nderë
Na dha lavdinë
Ta ktheshim për të mirë
Dritën dhe lirinë!*

Enes Ramadani 10/1

SPORT

SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" ORGANIZON TURNIR PËR NDER TË 17 SHKURTIT

Për nder të 17 Shkurtit, ShML "Medreseja Alauddin" organizoi një turnir të futbollit. Turniri u mbajt në ambientet e paraleleve të Prishtinës.

Në këtë turnir morën pjesë 4 ekipe, ku dy ishin përfaqësues nga paralelja e Prishtinës, një nga ajo e Gjilanit dhe një nga Prizrenit.

Në renditjen e ekipeve garuese, vendin e parë e mori paralelja e Gjilanit, vendin e dytë e mori paralelja e Prizrenit, ndërsa vendin e tretë dhe të katërt e mori paralelja e Prishtinës.

Pas turnirit, nxënësit e dy paraleleve vizituan ambientet e shkollës amë si dhe shikuan fotot e nxënësve nga ekspozita e 17 Shkurtit.



GJILANI

1



PRIZRENI

2



PRISHTINA A

3



PRISHTINA B

FUTBOLLI TE VAJZAT

Me datë 19.04.2022 "Medreseja Alauddin" ishte pjesëmarrëse në Garat Komunale të Futbollit me konkurrencën e vajzave, të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor – Prishtinë. Ekipi u përfaqësua nga:

1. Lindita Makolli 12/4
2. Imrane Zariqi 11/4
3. Amina Rahova 11/3
4. Albiona Musliu 11/4
5. Majlinda Zeka 10/4
6. Agnesa Berisha 10/5



TURNEU I BASKETBOLLIT PËR MESHKUJ



Me datën 19.11.2021 nxënësit e Medresesë ishin pjesëmarrës në turneun komunal të basketbollit të organizuar nga Federata e Sportit Shkollor në Prishtinë. Turneu u mbajt në ambientet e gjimnazit “Sami Frashri” ku ekipi ynë luajti kundër ekipit të kësaj shkolle, por fati nuk ishte në anën tonë dhe rezultuam me humbje, megjithatë djemtë tanë dhanë një performancë të kënaqshme.

Ekipi i shkollës tonë u përfaqësua nga: Muhamed Morina, Said Kosumi, Fejsal Tërnavë, Uvejs Smajli, Suhejb Fetahi, Nur Lushta, Behar Ahmeti, Amar Nesimi, Malsor Ajeti dhe Enis Islami.

Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë gjimnazin “Sami Frashëri” për mikpritjen e ngrohtë që na e ofruan. Shkolla jonë do të vazhdojë të jetë pjesëmarrëse e aktiviteteve tjera sportive edhe në të ardhmen.



TURNIRI NË VOLEJBOLL, VAJZAT

Me 14.02.2022 në shkollën amë, në Prishtinë u organizua turniri në volejboll, për vajza, ku morën pjesë nxënëset me ekipet e tyre nga shkolla Amë, nga Prizreni dhe Gjilani. Ky organizim ndërmjet tyre ishte një mundësi e mirë për të u takuar, për ta njohur njëra tjetrën për të u njohur me ambientin e shkollës si dhe me drejtorinë dhe stafin e shkollës.

Turniri u organizua në vazhden e aktiviteteve për hir të 17 Shkurtit- Shpalljes së Pavarësisë.

Renditja e ekipeve garuese:

*Prishtina - vendi i parë,
Prizreni - vendi i dytë,
Gjilani - vendi tretë.*



GARAT KOMUNALE NË SHAH NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Me datë 09.12.2021 nxënësit e "Medresesë Alauddin" morën pjesë në Garat Komunale të Shahut. Garat u mbajtën në ambientet e ShFMU "Asim Vokshi"- Prishtinë. Ekipi ynë shfaqti performancë të shkëlqyer dhe në konkurrencë me të gjitha shkollat pjesëmarrëse arriti të renditet në vendin e 3-të në nivel komunal.

Ekipi ynë u përfaqësua nga nxënësit: Leart Mehani, Almir Isaku, Shuaib Bytyqi, Venis Sijarina, Rumejsa Raçi dhe Saime Hoti.

Medreseja do të vazhdojë të jetë pjesëmarrëse e aktiviteteve tjera sportive edhe në të ardhmen.



MEDRESEJA ALAUDDIN FILLON VITIN 2022 ME ARRITJE MJAFT TË KËNAQSHME NË GARËN E PINGPONGUT

Me datë 17.01.2022 ShML "Medreseja Alauddin" mori pjesë në Garat Komunale të Pingpongut të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor – Prishtinë.

Garat u mbajtën në Pallatin e Rinisë, në ambientet e sallës së Federatës së Pingpongut të Kosovës. Shkolla jonë mori pjesë në të dy konkurrencat, në atë të meshkujve dhe të femrave.

- Ekipin e djemve e përfaqësuan: Omer Hasani, Ubejd Haziri dhe Musab Hoxha dhe arritën të renditen në vendin e tretë, në nivel komunal.

- Ekipin e vajzave e përfaqësuan: Rumejsa Hyseni, Lule Lulaj dhe Adelina Ruhani.

Nxënëset tona ishin mjaft të përgatitura dhe arritën të renditen në vendin e dytë, në nivel komunal, dhe iu nda medalja e argjendtë.



ZONJA SHPRESA SHALA, DREJTORE E DKA -SË PRISHTINË, VIZITON MEDRESENË

Më datën 02.12.2021 zonja Shpresa Shala, drejtoreshë e DKA-së Prishtinë, me një pjesë të stafit të saj, vizitoi ShML “Medreseja Alauddin”, për t’u njohur nga afër me punën dhe procesin mësimor që zhvillohet në shkollë.

Ajo shprehu konsideratë dhe vlerësoi punën arsimore-edukative që zhvillohet në Medrese, e cila është në trendin e duhur me zhvillimet në avansimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë, duke qenë lidere në digjitalizimin e shkollës.

Drejtori i Medresesë z.Fadil Hasani e falënderoi dhe shprehu mirënjohjen ndaj zonjës Shpresa Shala dhe stafit të mrekullueshëm të DKA-së në Prishtinë, për bashkëpunimin, mbështetjen dhe gatishmërinë për t’i mbështetur proceset nëpër të cilat po kalon shkolla.

Amir Pajaziti 12/2



MEDRESESË I SHTOHET EDHE NJË HAFIZ

Ubejd Salija, nxënës i ShML “Medreseja Alauddin”, në fund të periodës së dytë mori titullin zyrtar “HAFIZ I KURANIT”, Bashkësia Islame e Kosovës organizoi konkursin për marrjen e certifikatës së hifzit, ku kanë marrë pjesë hoxhallarë të komunave të ndryshme dhe disa hafiz nga shteti i Turakisë, ku është testuar.

Pasi e kaloi me sukses provimin, atij iu nda certifikata hifzit. Allahu e begatofte me shëndet dhe jetë të gjatë !



DREJTORI I SHKOLLËS MAARIF Z. OGUZ HAMZA YILMAZ, VIZITON MEDRESENË

Më datën 02.12.2021 ShML"Medreseja Alauddin" drejtori i shkollës Maarif z. Oguz Hamza Yilmaz vizitoi ShML" Medresja Alauddin" ku u prit nga drejtori i saj, z.Fadil Hasani dhe stafi arsimor, për të vazhduar bashkpunimin e më tutjeshëm dhe përvojat e tyre në fushën e arsimit.

Në këtë takim u dhanë ide të ndryshme për ato fusha në të cilat mund të zhvillohet bashkëpunimi.



MINISTRI I ÇËSHTJEVE FETARE TË ARABISË SAUDITE VIZITOI MEDRESENË

Më 28 tetor 2021, ShML" Medresja Alauddin" kishte nderin që ta priste ministrin e çështjeve fetare të Arabisë Saudite, dr. Abdul-Latif bin Abdul Aziz al-Shejkh dhe delegacionin saudit. Ata të shoqëruar me Myftiun e Kosovës, z. Naim Tërnavë u pritën nga drejtori i shkollës, z. Fadil Hasani, nga prof. Ahmet Rama dhe nga stafi edukativo-arsimor, si dhe më pas, patën rastin të bisedojnë edhe me nxënësit e Medresesë.





Republika e Kosovës

Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës

SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË



Klasa 12/1



Klasa 12/2



“...E UNË NXITOVA TE TI, O ZOTI IM,
PËR TA FITUAR KËNAQËSINË TËNDE.”
(Ta Ha, 84)

Gjenerata 55
2019/2022
Takimi 2032



SHPALLEN NXËNËSIT E DALLUAR NË MEDRESE GJATË VITIT SHKOLLOR 2021/2022



Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
Sh.Mb. "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË

**NXËNËSIT
E DALLUAR**



EMIR MEHANI 12/2
më i dalluar në nivel shkollor



RINOR SYLJA 12/1



HARITH ABAZI 12/2



BURHAN AVDULLAHU 11/1



AMËR SUMA 11/2



ART ISLAMI 10/1



REIS MEHANI 10/2



ARIF EMIRI 10/3



Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
Sh.Mb. "MEDRESEJA ALAUDDIN" - PRISHTINË

**NXËNËSET
E DALLUARA**



BELTINË KAMENICA 12/4
më e dalluara në nivel shkollor



ALDINA ZEJNULLAHU 12/3



MEDINA BREGAJ 11/3





SARAFINA RETKOCERI 11/4



ELJESA MAXHUNI 10/4



REPUBLIKA E KOSOVES
BASHKESIA ISLAME E REPUBLIKES SE KOSOVES
MEDRESEJA E MESME "ALAUDDIN"
PRISHTINE






في هذه المسلى الى الله على بصيرة وان العيس
"Thuaj: 'Kjo është rruga ime, në të cilën themrras në bazë të një
vizioni të qartë, unë dhe të gjithë ata që më pasojnë mua...'
Tërija Jusuf Dbi



KLASA 12/3

KLASA 12/2

KLASA 12/1





Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
MEDRESEJA E MESME "ALA UDDIN" - PRISHTINË



"Por ti mullëtoje me fjalënderime Zotin
tënd, dhe bëjnë prej tyre që lutem!
Dhe adhurojë Zotin tënd derisa të
të vijë vdekja!"
(Kurane: 1:5-98-99)



Gjenerata e 20-të
Tëdhënës 2031

